

UNIVERSITETI I EJL
ЛНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ
LAW FACULTY



STUDIMET PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

PROGRAMI – E DREJTA CIVILE

TEMA:

**“ROLI I NOTERIT NË TË DREJTËN TRASHËGIMORE MAQEDONASE
DHE KRAHASUESE”**

Mentori:

Doc. dr. Arta Selmani – Bakiu

Kandidati:

Arta Iseni Konjufca

Shkup, 2021

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE	4
ABSTRAKT	5
METODOLOGJIA	7
HIPOTEZAT.....	8
HYRJE	9
1 PËR NOTERINË NË PËRGJITHËSI.....	10
1.1 Zhvillimi historik i noterisë.....	12
1.2 Organizimi i Noterisë dhe organet e saj.....	16
1.2.1 Oda e Noterisë.....	16
1.3 Noteria dhe veprimtaria e saj në RMV.....	17
1.4 Të drejtat dhe detyrat e noterit	18
1.5 Refuzimi i marrjes së veprimit zyrtar.....	19
1.6 Kompetencat dhe autorizimet e noterit	19
1.7 Tiparet dhe fuqia e aktit noterial	20
1.7.1 Përmbajtja e aktit noterial	21
1.8 Marrja e dokumentit, parave dhe letrave me vlerë për ruajtje dhe dorëzim.....	23
2 NOTERIA DHE E DREJTA TRASHËGIMORE.....	24
2.1 Trashëgimia.....	25
2.1.1 Trashëgimia me ligj	26
2.1.2 Trashëgimia me testament	31
2.1.3 Pavlefshmëria e testamentit	32
2.1.4 Kontrata mbi ndarjen dhe bartjen e pasurisë gjatë jetës së trashëgimlënësit– Cedimi.....	33
2.2 Vdekja e personit.....	34
2.2.1 Aktvdekja.....	34
3 PROCEDURA TRASHËGIMORE SIPAS LEGJISLACIONIT POZITIV TË RMV-SË ...	36
3.1 Fillet e zhvillimit të procedurës trashëgimore nga noterët.....	38
3.1.1 Seanca për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.....	40
3.2 Noteri si i besuar i gjykatës.....	41

3.2.1	Ndërpreja e procedurës së shqyrtimit të pasurisë trashëgimore	43
3.2.2	Aktvendimi për shpalljen e trashëgimtarëve.....	44
3.3	Procedura me testament	45
3.4	Statistika për numrin e lëndëve të pranura nga Noterët për çështjet trashëgimore në RMV.....	46
4	NOTERI NË TË DREJTËN E KRAHASUAR.....	49
4.1	Noteria dhe e drejta trashëgimore në Shqipëri	49
4.2	Noteria dhe e drejta trashëgimore në Kosovë	54
5	PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	60
5.1	Intervista me noteren Ermira Mehmeti (e realizuar më 09.12.2020).....	60
5.2	Intervista me noterin Naser Ziberi (e realizuar më 10.12.2020).....	62
5.3	Intervista me noteren Nita Xhaferi Iseni (e realizuar më 18.12.2020).....	64
5.4	Analiza dhe krahasimi i të dhënave të përfituara nga intervistat	67
5.4.1	Krahasimi i të dhënave nga intervistat.....	67
5.5	Anketa	69
6	PËRFUNDIMI.....	77
7	LITERATURA E SHFRYTËZUAR.....	80

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

Figure 1: -Rendi i parë i trashëgimisë ligjore	27
Figure 2:-Rendi i dytë i trashëgimisë ligjore	28
Figure 3:E drejta e përfaqësimit në rendin e dytë të trashëgimisë ligjore	29
Figure 4:E drejta e shtimit në rendin e dytë të trashëgimisë ligjore	29
Figure 5: Rendi i tretë i trashëgimisë ligjore	30
Figure 6: E drejta e përfaqësimit në rendin e tretë të trashëgimisë ligjore	30
Figure 7: Gjinia	70
Figure 8: Mosha	70
Figure 9: Përkatësia etnike.....	71
Figure 10: Profesion.....	71
Figure 11: A i besoni noterit në punën e tij në çështjet e procedurës trashëgimore	72
Figure 12: Nëse po sa.....	73
Figure 13: A keni qenë pjesëmarrës në ndonjë procedurë për shqyrëtimin e trashëgimisë.....	73
Figure 14: Si mendoni, a i realizojnë noterët në mënyrë të drejtë dhe të paanshme procedurat e trashëgimisë	74
Figure 15: A jeni pro barazimit të bashkësië martesore dhe jashtëmartesore në trashëgiminë ligjore	75
Figure 16 : A jeni pro barazisë gjinore në trashëgimi.....	75
Figure 17: A konsideroni që me anë të testamentit sigurohet vullneti i fundit i trashëgimlënësit	76
Table 1: Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2017	46
Table 2: Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2018	47
Table 3: Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2019	48

ABSTRAKT

Në këtë studim vendosen në pah dy çështje kryesore, të cilat në njërin anë janë të ndarë nga njëri-tjetri, kurse në anën tjetër kemi ndërlidhjen e këtyre dy lëndëve të cilët janë noteria dhe e drejta trashëgimore.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizohet dhe të krijohet një pasqyrë për rolin e noterive dhe ndikimin e tyre në të drejtë trashëgimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si një shërbim juridik që ofrohet, ndikimin e noterisë në përmirësimin e këtyre aspekteve juridiko-shoqërore, si dhe duke krahasuar rolin e noterit në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.

Në fillim të punimit shqyrtohet zhvillimin historik i noterisë, veprimtarinë dhe autorizimet e këtij institucioni të rëndësishëm, si dhe të drejtat dhe detyrimet e noterit ndaj subjekteve.

Në kapitujt vijues përqëndrimi është në rolin e një noteri në procedurat e trashëgimisë. Premisa për të filluar procedurat e trashëgimisë është vdekja e një subjekti personal. Vetëm atëherë një noter emërohet nga gjykata për veprime në procedurat e trashëgimisë.

Më tej, përshkruhen aspektet sipas të cilave gjykata emëron një noter dhe si të njohim një noter brenda procedurës së trashëgimisë. Përcaktohen pjesëmarrësit në procedurë, sepse vetëm me ata mund gjykata si dhe noteri të procedojnë në procedurat e trashëgimisë. Pjesa tjetër e tezës sime përqëndrohet në hetimin paraprak. Brenda hetimit paraprak, noteri zbulon përmbajtjen e dokumenteve të rëndësishme për procedurat e trashëgimisë. Për sa më sipër, renditen dokumentet e mëposhtme: testamenti i fundit, akti i trashëgimisë, akti i administrimit të trashëgimisë, kontrata e trashëgimisë, të cilat duhet të rregullohen me ligj.

Në pjesën e fundit të tezës përqëndrimi është në të kuptuarit më të mirë të rolit të noterisë duke përdorur edhe metodat e intervistës, që kuptimi i arritur të jetë sa më i detajuar dhe qëllimi kryesor të jetë sa më i kuptueshëm. Dhe si përfundim pas intervistës, kam përdorur një lloj të anketimit me një mostër të thjeshtë, që do të nënkuptonte arritjen e qëllimit të caktuar për zhvillimin e më tutjeshëm dhe arritjen e objektivave të caktuara për mendimin e qytetarëve në lidhje me sigurinë që kanë ndaj noterëve sa i përket të drejtës trashëgimore.

Ky studim konfirmon se noteria luan një rol mjaftë të rëndësishëm në procedurat trashëgimore. Funkzioni noterial është një funksion publik për të cilin zbatohen rregulla të veçanta të përgjegjesisë si kundërvënie në funksionin e gjyqësorit. Edhe pse nuk është një funksion shtetëror, kryerja e veprimtarive me interes publik në sistemin tonë juridik barazohet për sa i përket përgjegjesisë me kryerjen e detyrës zyrtare të organeve shtetërore, e cila nga ana tjetër vetëm konfirmon nevojën për të marrë në konsideratë format e përgjegjesisë me noterin.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur gjatë punimit të diplomës në përgjithësi është adresuar në objektivat e tij kryesorë, është i orientuar më shumë nga një kërkim të literaturës adekuate. Kërkimi starton me hulumtime mbi kuptimin e kësaj teme, bazuar në kërkime e materiale ekzistuese, dhe vijon me shpjegimin e modelit të sjelljes së tij dhe një krahasim midis gjendjes aktuale dhe ndryshimeve që do të kalojnë.

Për të përmbushur disa nga objektivat dhe drejtimin e kësaj teme, është ndërmarrë rishikimi i një literature të gjërë që fokusohet në shpjegimin mbi karakteristikat kryesore. Ndërkohë, të dhënat dytësore të mbledhura kanë ndihmuar për të njohur e kuptuar çështjet kryesore.

Burime të të dhënave dytësore përfshijnë:

- Studime të mëparshme e raste studimi në këtë fushë,
- Artikuj,
- Raporte,
- Tabela statistikore,
- Baza të dhënash në internet etj.

Përgjithësisht është punuar për të gjetur informacionin më të përditësuar të mundshëm, dhe të dhënat e disponueshme.

Në këtë hulumtim përdoren metodat e kërkimit në të drejtën trashëgimore, në të drejtë e noterisë, në fushën e rregullimit të legjislacionit për trashëgimi në Republikën e Maqedonisë, Kosovës, dhe Shqipërisë dhe për familjen. Gjithashtu do të analizohen të dhënat e nxjerra nga institucionet relevante si Oda e Noterëve, zyrat e noterive, dhe agjencitë e ndryshme. Për hulumtim në këtë punim janë përdorur metoda për krahasimin e të dhënave që të arrihen rezultate të duhura se si janë zgjedhur rastet e trashëgimisë përmes noterëve. Në vazhdimin e temës për të kuptuar më mirë rolin e noterisë do të përdorim edhe metodat e intervistës, që kuptimi i arritur të jetë sa më i detajuar dhe qëllimi kryesor të jetë sa më i kuptueshëm. Dhe si përfundim pas intervistës, një lloj i anketimit me një mostër të thjeshtë do të nënkuptonte arritjen e qëllimit të caktuar për zhvillimin të mëtutjeshëm dhe arritjen e objektivave të caktuara për kompletimin e metodologjisë së përdorur.

HIPOTEZAT

Duke analizuar rolin e noterisë në të drejtën trashëgimore dhe shtjellimit të literaturës adekuate do paraqesim dy hipoteza të cilat do të qartësohet në përfundim të temës.

Rëndësia e rolit të noterit në procedurën trashëgimore dhe besueshmëria e krijuar.

Roli i noterit në të drejtën trashëgimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut krahasuar me vendet në rajon.

Hipotezat që kemi ngritur në këtë punim tregojnë për ndërlidhjen e noterit që rezulton një ndikim shumë të madh me besueshmërinë e krijuar dhe për shtjellimin e procedurave gjatë aplikimit në marrjen e vendimeve të drejta, ku synon vërtetësinë e trashëgimlënësit dhe trashëgimtarit, ndërsa tek e drejta trashëgimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut krahasuar me vendet e rajonit dhe dallimet mes vendeve në marrjen e përgjegjësive dhe në përcaktimin e të drejtës trashëgimore. Pasi që vendet e rajonit janë pothuajse me një ligj shumë të ngjajshëm me njëra tjetrën do të mundohemi të kuptojmë se ku egziston diferenca e të drejtës rreth çështjeve të njëjta trashëgimore.

Shtjellimi dhe kuptimi i rolit të noterive ka shumë dimensione dhe rol kyq gjithmonë luan e drejta se si duhet vepruar në çështje të caktuara ku janë ose do kenë efekte të mëvonshme marrja e vendimeve për të drejtën trashëgimore. Pasi që çdo vendim i marrë është i definuar me anë të ligjit për trashëgiminë atëherë nuk parashihet që të ketë ndonjë pengesë për marrjen e vendimeve për çështjen e tjetërsimit të trashëgimtarit kur të jetë e nevojshme dhe parashtrimi i parregullsive parashihet të jetë minimal për vendosje të trashëgimtarit.

HYRJE

E drejta është një element kryesor i kulturës së një vendi . Ajo ka një ndikim të veçantë në shoqërinë dhe sjelljen e individëve. E dejta i përcjell të gjitha dinamikat e zhvillimit të shoqërisë, qofshin ato politike, ekonomike apo sociale. Vendi dhe roli i noterisë në këto procese është i padiskutueshëm.

Neni 3 Ligji për Noteri i Maqedonisë së Veriut noterin e përkufizon si person që kryen autorizime publike të përcaktuara me ligj, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë, i cili shërbimin e noterit e kryen si profesion të vetëm profesional.¹ Shërbimi i noterisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është njëri nga shërbimet juridike publike me qëllim të mbrojtjes së interesave të ligjshme të personave juridikë dhe fizikë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ligjet.

Zyrat e noterëve ofrojnë shërbime juridike për çështje familjare dhe trashëgimore për çështje pronësore, për çështje ekonomike dhe të punës, shërbime juridike nga rruajtja e gjërave dhe dokumenteve të tjera, shërbime juridike lidhur me vërtetimet, legalizimet dhe çertifikatat e tjera.² Noteri është një person, i cili bën shumë aktivitete ligjore, dokumente ligjore dhe marrëveshje ligjore. Një nga aktivitetet e tij është një aktivitet gjatë procedurës së trashëgimisë.

Shërbimi noterial luan një rol shumë të rëndësishëm në mirë-funksionimin e vendeve moderne. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë shërben për t'iu përgjigjur kërkesave të qeverisë, bizneseve dhe qytetarëve. Duke marrë parasysh dinamikën e jetës, në një pikë të caktuar të jetës pothuajse të gjithë do të duhet të marrin shërbime noteriale, si: kontrata të biznesit, autorizime, vërtetime, blerje të pasurisë së paluajtshme, lloje të ndryshme të deklaratave me shkrim, testamente etj.³

¹ Neni 3, Ligji për Noteri I RMV, gazeta zyrtare nr.72/2016

² <https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/334/11-Shqipe-Shaqiri-Roli-i-noterive-n%C3%AB-trash%C3%ABgimin%C3%AB-e-.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

³ Agim Kasaj “Analiza e kënaqësisë, impaktit individual dhe organizacional në adoptimin e sistemeve të detyrueshme e- Government: Rasti i noterisë dixhitale në shqipëri” , 2018, faqe 123 nga https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/10/Punimi_Final_-Agim-Kasaj.pdf

1 PËR NOTERINË NË PËRGJITHËSI

Shërbimi i noterisë në Maqedoninë e Veriut ka për qëllim shërbimet juridike për mbrojtjen e interesave të qytetarëve në pajtim me rregullat e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shërbimi noterial është një shërbim publik, i ushtruar nga noterët e caktuar nga ministria e drejtësisë siç rregullohet me ligjin për noterinë. Me Ligjin për Noterinë rregullohet organizimi dhe funksionimi i noterëve si veprimtari publike në Maqedoninë e Veriut, kushtet dhe metodat e punës, kushtet për t'u pranuar si noter, dhe të drejtat dhe detyrimet e noterëve. Ai rregullon edhe organizimin dhe funksionimin e Odës së Noterëve dhe marrëdhëniet e saj me Ministrinë e Drejtësisë.⁴ Organet e Odës janë: Kryetari/Zëvendës Kryetari, Këshilli disiplinor, Këshilli profesional, Kuvendi, Bordi drejtues; Bordi mbikqyrës dhe organe tjera të parapara me Statutin.⁵

Bazën dhe arsyen e ekzistimit të saj, noteria e gjen në formën autentike: institucioni noterial ka lindur nga nevoja që të sigurohet dëshmia e pakontestueshme e fakteve ose e akteve juridike dhe që t'u japë akteve të formave të tilla fuqinë e ngjajshme si të atyre të vendimeve gjyqësore.⁶

Noteri është ushtrues i një misioni të besimit në shumë pikëpamje. Nga ky mision burojnë tri kërkesa, njohja e mirë e profesionit, respektimi i rregullave jashtëzakonisht të ashpra të moralit dhe detyrimi i dhënjes së ndihmës dhe i këshillave.⁷

Në rolin e tij të profesionistit i cili furnizon shërbime me standarde të nivelit të lartë për qytetarët, noteri gëzon një respekt të madh, sidomos në lëminë e transaksionit të palujtshmërive. Akti noterial i cili lidh një transaksion të paluajtshmërive është njëri nga vendimet më të rëndësishme në jetën e një qytetari; është një akt falë të cilit qytetari mund të çojë, sikur vetë ashtu edhe familjen e tij, një jetë të rehatshme. Noteri ushtron një funksion shoqëror të rëndësishëm madhore në çastet më të rëndësishme të jetës së një qytetari; gjatë jetës së tij qytetari duhet disa herë të marrë vendime të rëndësishme të cilat prodhojnë efekte juridike. Të mos shkojmë shumë larg dhe të mendojmë për martesën, shkurorëzimin, blerjen e një prone, themelimin e një ndërmarrje apo për përpilimin e një

⁴ Swiss Cooperation Office Kosovo -UNDP

<https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/ResearchAndPublications/Saek/VLER%C3%8BSIMI%20I%20RISKUT%20P%C3%8BR%20OD%C3%8BN%20E%2Ffinal.pdf>

⁵ Neni 117, Ligji i Noterisë në RMV-se, Gazeta zyrtare nr.72/16

⁶ Perre Rochat, "Quelques reflexions sur la profession de notaire" in JDT 1966 III 2001, fq.93

⁷ Annee, Revue notariale belge, Bruxelles, 13 October 2014, fq. 243

testamenti. Pasi përjetojmë procese të shumëfishimit të ligjeve, duke mos harruar kompleksitetin e tyre, është vështirë të mendohet matja apo vlerësimi i vendimeve të tilla të natyrave të ndryshme, pa ndihmën e një profesionisti të drejtësisë siç është noteri.⁸

Noteria është shërbim që bën autorizime publike, në mënyrë të saktë të rregulluar me ligj, e si e tillë bie nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë, si ministri amë e cila vendos për çdo ndryshim në mënyrën e kryerjes së shërbimeve noteriale. Në sistemet juridike moderne të vendeve evropiane dominon modeli latin i noterit, dhe ky model është pranura gjithashtu edhe nga Maqedonia e Veriut.

Fusha tradicionale e aktiviteteve publike të noterisë kanë të bëjnë me ligjin e trashëgimisë, të drejtën familjare dhe çështjet ligjore në lidhje me disponimin e pasurisë, statusin e ndryshëm dhe gjëra të ndryshme, siç janë vërtetimi i shkrimit të dorës, nënshkrimi, transkriptimi, përkthimi dhe të ngjashme. Raporti ligjor i shërbimit publik noterial është në fakt marrja e juridiksionit në lidhje me përgatitjen dhe lëshimin e duhur të dokumenteve, çertifikatat zyrtare, depozitat dhe trajtimin e urdhëruar nga gjykata.

⁸ Lirim Begzati, “Noteria jonë”, Arbëria Design 2010, faqe 18

1.1 Zhvillimi historik i noterisë

Noteria si institucion është i vjetër. Në kohën klasike të së drejtës romake, në periudhën nga shekulli V para Krishtit deri në shekullin e III pas Krishtit, talenti dhe aftësia me të cilën do të merreshin noterët më vonë, u formuan dhe u përsosën, por megjithatë në kushtet që parandaluan shfaqjen e noterëve si shërbim autonom. Deri në shekullin III para Krishtit, me shkencën e së drejtës romake “Jurisprudencia”, siç e quanin vetë romakët, e referuar në të drejtën private, merrej kolegji i priftërinjve shtetërorë (*Sacerdotes publici*), kuptimi dhe veprimtaria e të cilit nuk kishin asnjë karakter ezoterik, sepse ato në fakt kryenin shërbim paralel, të cilën e kryenin mjeshtrit.⁹

Kështu duke iu referuar Romës së Vjetër, në shoqërinë romake vepronin shkruesa që emërtoheshin “tabeliones”, që quheshin kështu për shkak se aktet i shkruanin në pllaka (tabela) të vogla të lyera me dyllë. Në Romë, përveç tabelioneve vepronin edhe shkrues private në shërbim të të pasurve, që zakonisht ishin skllëvër dhe që quheshin noterë (noteri) nga fjala “nota” që do të thotë shenja konvencionale të shkurtuara të përdorura prej tyre për shpejtësinë e shërbimeve.¹⁰

Korrigjimet e asaj epoke nuk ishin rregullime të besimit publik. Procedura gjermane, e cila në atë kohë ishte rregulli i çështjeve civile, me përbërjen e saj të provave të rregullta, të cilat nuk u referoheshin fakteve që justifikonin ekzistencën e të drejtës, por në ekzistencën e vetë ligjit nuk mund të pranohej asnjë rol i drejtpërdrejtë për provat dokumentare. Nëse një dokument lejohej të paraqitej, kërkohesh gjithashtu një betim - palës ose dëshmitarit që e nënshkroi për të vërtetuar. Sidoqoftë, megjithëse akti privat në formën e një dokumenti të redaktuar saktë në kohën mesjetare nuk mund të konsiderohej një akt autentik, ai ishte akoma prova më e fortë racionale në disa situata ligjore. Një dokument i tillë nuk ishte autentik, por gjithsesi ishte i autorizuar. Me këtë mund të shpjegohej qëndrueshmëri, edhe më tepër, fluturimi që në thelb ajo epokën përjetoj “ars dictandi” si një element i përbërjes shkollore dhe kulturore, të paktën në periudhën më të rëndësishme evropiane të atëhershme, veçanërisht në Itali.¹¹

⁹ Dragan Tumanovski , “Zhvillimi historik i noterisë në Evropë dhe Noteria në R.Maqedonisë”, Notarius nr.1, faqe 13

¹⁰ Po aty, faqe 16

¹¹ Dragan Tumanovski , “Zhvillimi historik i noterisë në Evropë dhe Noteria në R.Maqedonisë”, Notarius nr.1, faqe 16

Profesioni i noterit mesjetar ishte i gjatë mes zhvillimit të jurisprudencës dhe letërsisë. Mjeshtërit e “ars notaria” të paktën në qendrat më të rëndësishme si Bolonja, Padova dhe Perugia, nuk studionin në fakultete juridike, por në ato për artistë, domethënë në fakultete filozofike (sipas standardeve të sotme). Kjo nuk i ndaloi noterët më të rëndësishëm për të studiuar juridik. Për këtë noterët-juristë kanë qenë veçanërisht të shkolluar, madje më shumë se vetë avokatët.

Karakteristikat e veçanta të noterëve në Mesjetë garantoheshin nga një organizim rigoroz profesional, e cila në mënyrë rigoroze mbikqyrte praktikën e kryer jo-verbale, impononte prova me qasje shumë serioze dhe kontrollonte sjelljen e neneve të tyre, do të thotë organizimi aprovoi ta rrënjësojë kredibilitetin absolut të noterit dhe reputacionit publik të tij. Në mesjetën e Italisë akteve noteriale filloi të i’u jipet autenticiteti në fund të shek. XI dhe filimit të shekullit XII. Akti noterial nga shekulli XII është autentik, sepse buron nga një subject i cili me atë kualitet ka mundur të garantojë: nga njëra anë, ai ka qenë i aftë që në mënyrë precize ta vërtetojë përmbajtjen aktidhe ta shkruajë në mënyrën më të mirë të mundshme për realizimin e qëllimeve të tyre, nga ana tjetër, ka disponuar me integritet dhe organizim të veçantë për ruajtjen e akteve.¹²

Noteri modern Evropian (Latin) lindi në veri të Italisë në pjesën veriore të Italisë qendrore. Definitivisht u pranuar në kohën e sundimit të Perandorit Frederick Barbarossa dhe Papa Aleksandri III. Nga Italia u përhap në Evropë në disa drejtime. Drejtimi i parë u përhap nga Marcel (1185), zuri Lyon (1220), pastaj përmes Grenoble dhe Savoy, preku zonën zvicerane të Shën Moritz në mes të shekullit të X, midis 1250 dhe 1260. Drejtimi i dytë përmes Valencias çoi në Spanjë më 1239. Rruga veriore fillon në Lizzie 1274 dhe përmes Osnabrück arrin në Lubeck më 1283. Në Angli noterët italianë arrijnë më 1257, dhe noterët lokalë u emëruan më 1279. Në Danimarkë për noterët flitet që nga fundi i shekullit XIII.¹³

Përvojat e shumë vendeve dhe zgjidhjet ligjore, siç janë Franca, Rusia, Italia, Gjermania, Austria, Suedia Sllovenia, Kroacia, Polonia, Turqia dhe disa shtete në Shtetet e Bashkuara, ka parasysh edhe gjatë përgatitjes së ligjit tonë për kryerjen e punëve noteriale, i cili miratohet për herë të parë në vendin tonë. Në zhvillimin historik të vendit tonë deri më tani, nuk kishte asnjë institucion të këtij lloji, kështu që gjatë përgatitjes së Ligjit duhet të ishim veçanërisht të

¹² Tumanovski , “Zhvillimi historik i noterisë në Evropë dhe Noteria në R.Maqedonisë”, Notarius nr.1, faqe 17

¹³ Po aty, faqe 17-18

kujdesshëm, sepse nuk kishim përvojë as të llojit privat, e as të llojit të noterit shtetëror. Në zhvillimin aktual dhe në përputhje me Ligjin e vjetër për Gjykatat e Rregullta, çështjet jashtëgjyqësore në lidhje me çështjet noteriale janë vendosur nën juridiksionin e gjykatave komunale, të tilla si verifikimi i nënshkrimeve dhe marrja e deklaratave. Ligji i ri për gjykatat përcakton që çështjet jashtë gjyqësore do të kryhen nga gjykatat vetëm si një përjashtim. Në pajtim me atë vendim, çështjet jashtëgjyqësore me ligj vendoset nën juridiksionin e një organi ose institucioni tjetër, ofrohet një zgjidhje sistematike për një qasje normale në hartimin e Ligjit për çështjet e noteriale që të mos kontestohet midis subjekteve, për të cilat nuk është e nevojshme për tu dëgjuar në gjykatë. Këto janë kriteret themelore që përcaktojnë fushën e punëve të noterisë në këtë ligj, i cili gjithashtu do të aplikohen në të ardhmen me prurjen e ligjeve tjera për procese jashtëgjyqësore.¹⁴

Me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, është krijuar një bazë kushtetuese për çështje të jashtme gjyqësore të caktuara për transaksione juridike dhe të padiskutueshme ndërmjet personave juridikë që do të kryhen si autoritete publike nga një shërbim i pavarur publik i përshkrimit të instituteve të ligjit për zhvillimin historik të noterit evropian (latin). Për kuptim më të mirë të instituteve të ligjit do të ipja një përshkrim të shkurtër të zhvillimit historik të noterit evropian (latin). Noteri latin, siç njihet sot në pjesën më të madhe të Evropës perëndimore dhe qendrore, i cili ekziston në botën e Amerikës Latine dhe po depërton gjithnjë e më shumë në vende të ndryshme të Azisë dhe Afrikës. Fillimet e këtij shërbimi duhet të gjurmohen që nga mesjeta e zhvilluar, megjithëse aktivitetet që e përbëjnë atë u kryen në mënyra të ndryshme, në prona të ndryshme dhe me efekte të ndryshme tek njerëz të ndryshëm që nga kohërat romake.¹⁵

Noterët e parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut filluan me punë në qershor të vitit 1998, ndërkaq shumë shpejtë po në atë vit u themelua edhe Oda e Noterëve e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organet tjera. Veprimtarinë që bëjnë sot noterët, në atë kohë kanë qenë nën kompetencë të gjykatave në procedurë jashtëkontestimore. Me ardhjen e ligjit për gjykatat u krijuan kushte që një pjesë e punëve jashtëkontestimore të merren nga gjykatat dhe u zhvendosën nën kompetencë të noterëve. Kufizimi i kompetencës së gjykatave dhe organet

¹⁴ Dragan Tumanovski, "Zhvillimi historik i noterisë në Evropë dhe Noteria në R.Maqedonisë", Notarius nr.1, faqe 22

¹⁵ Po aty, faqe 12

drejtuese në njëren anë, dhe kompetencat e noterëve nga ana tjetër, është e rregulluar me Ligjin për kryerjen e punëve noteriale dhe me punën e deritanishme të noterëve nuk ka asnjë problem në atë kuptim.¹⁶

Noteria në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një rëndësi të veçantë për marrëdhëniet juridiko-ndërkombëtare. Kjo për faktin se në kushte reciprociteti, dokumentet noteriale të hartuara jashtë vendit kanë të njëjtën vlefshmëri ligjore, sikur të ishin lishuar në përputhje me ligjin për kryerjen e punëve noteriale. Me këtë fitohet shumë, në kuptim që përshpejton qarkullimin ligjor, fitohet në kohë dhe që është shumë e rëndësishme që i'u ikin hargjimeve të mëdha, nga ana tjetër.

Me zhvillimin e shoqërisë, roli i noterëve filloi të rritet dhe në aspektin ligjor ai ndryshoi, duke bërë që veprimtaria noteriale të përfshijë redaktimin e akteve noteriale, si dhe futjen e ligjit. Gjithashtu solli që noteri nëpërmjet kryerjes së një akti noterial të pasqyrojë çdo gjë që ai pa, dëgjoji dhe të cilën e pasqyron në aktin noterial, duke i dhënë një fuqi ligjore, pikërisht atij besimi publik të veprimeve të kryera prej tij, duke i garantuar ato nëpërmjet legalizimit të bërë prej tij. Mbi këtë bazë ligji sjell detyrimin e personave të cilët kanë marrë pjesë në redaktimin e një akti noterial dhe kryerjen e një eprimi juridik para noterit, duke iu nënshtruar ekzekutimit të tyre.¹⁷

¹⁶ Arsen Janevski, "Veprimtaria noteriale në R. Maqedonisë", Notarius nr.1, faqe 24

¹⁷ Av.Petraç Çuri, "E drejta procedural civile & Noteria", 2008, fq. 371

1.2 Organizimi i Noterisë dhe organet e saj

Noteria formohet nga të gjithë noterët e një vendi, të grupuar brenda një Ode të përbashkët ose organizatë kombëtare, të pavarur nga shteti, por që i përmbahet parimeve të drejtës publike dhe e njohur nga ligji. Sipas rrethanave, ky institucion duhet të grupoj Odat e ndryshme lokale brenda vendit dhe të vendoset nën mbrojtjen e Ministrisë së Drejtësisë.¹⁸

1.2.1 Oda e Noterisë

Sipas nenit 117 të Ligjit për noterinë Organet e Odës janë: Kryetari/Zëvendës Kryetari, Këshilli disiplinor, Këshilli profesional, Kuvendi, Bordi drejtues; Bordi mbikqyrës dhe organe tjera të parapara me Statutin. Oda mban regjistër të autorizimeve dhe regjistër të testamenteve, kurse mund të mban edhe regjistra tjerë publik dhe të tjerë, në pajtim me ligjin.¹⁹

1.2.1.1 Kompetencat e Kryetarit të Odës së noterisë

Kryetari i Odës është edhe kryetar i Bordit dhe kryeson me Kuvendin e Odës.

Kryetari i Odës:

- I zgjidh konfliktet ndërmjet noterëve, ndërmjet noterëve dhe zëvendës- noterëve të tyre ose ndihmës – noterëve ose ndërmjet noterëve dhe pjesëmarrësve të tyre në rast të kontestit i cili ka të bëjë me zbatimin e Ligjit ose për pagesë për punën e kryer;
- Kujdeset Oda të veprojë në pajtim me ligjin;
- Vendos për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në Shërbimin profesional të Odës;
- Parashtron propozim për ngritje të procedurës disiplinore kundër noterit;
- Vendos për kërkesë për përjashtim të noterit dhe caktim të noterit në rast të përjashtimit;
- I kryen punët të tjera të parapara me Statutin e Odës.
- Bordi drejtues i Odës mund ta autorizojë kryetarin e Odës në raste urgjente vetë të kryej punë të caktuara nga kompetenca e vet. Kryetari i Odës është i obliguar për çdo veprim të

¹⁸ Dentologjia dhe rregullat e organizimit të noterive, Dokument i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të noterive anëtarëve në Lima, me 8 tetor 2013, faqe 5

¹⁹ Neni 117, Ligji i Noterisë së RMV-së, Gazeta zyrtare nr.72/2016

tillë të marrë ta njoftojë Bordin Drejtues dhe të kërkojë leje për veprimin e marrë. Mosdhënia e lejes plotësuese nuk ndikon në rëndësinë e punës juridike ndaj personave të tretë.²⁰

1.2.1.2 Kuvendi i Odës së noterisë

Kuvendin e Odës e përbëjnë të gjithë noterët në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët janë të regjistruar në Listën e emrave të noterëve të cilin e mban Oda. E ruan prestigjin dhe nderin e kryerjes së punëve të noterit dhe kujdeset me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, që noterë t'i kryejnë detyrat e veta.²¹

1.2.1.3 Bordi drejtues

Bordin drejtues të Odës e konvokon kryetari i Odës ose me kërkesë të një të tretës të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit drejtues. Për plotfuqishmëri të vendimeve të Bordit drejtues është e nevojshme në seancë të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit drejtues. Vendimet miratohen me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Bordit drejtues. Me Statutin e Odës veçanërisht do të përcaktohet për cilat raste për plotfuqishmëri të vendimeve është e nevojshme shumicë e dy të tretave.²²

1.3 Noteria dhe veprimtaria e saj në RMV

Noteria është një profesion në vete që definohet përmes veprimtarisë shumë dimensionale dhe të gjërësishme. Shërbimet noteriale janë aq të shumta, sa edhe nevojat juridike të qytetarëve. Noteri duhet ta njohë mjaftë mirë ligjin dhe me atë njohuri ta zbatojë atë të drejtë. Veprimet noteriale duhet të jenë në përputhje me ligjin, me qëllim që të mos ketë hapësirë për interpretime, të cilat mund të dëmtojnë interesat e palëve pjesëmarrëse në veprimet ose aktet noteriale. Ai në mënyrë të vazhdueshme duhet të jetë në dijeni të ndryshimeve ligjore lidhur me

²⁰ Neni 123, Ligji i Noterisë së RMV-së, Gazeta zyrtare nr.72/2016

²¹ Neni 120, po aty

²² Neni 122, po aty

veprimtarinë e tij noteriale apo udhëzimet e dhëna nga Ministria e Drejtësisë. Noteri gjatë veprimtarisë së tij duhet të mbrojë interesat e shtetasve që paraqiten para tij dhe ndihmohen në veprimtarinë e tyre juridike. Ai duhet të karakterizohet me etikë e edukatë profesionale e nivelit të lartë, për t'u përgjigjur në çdo kohë interesave të klientëve, për veprime noteriale që janë të ngutshme apo redaktimin e akteve noteriale që kanë karakter shumë të ngushtë, siç mund të jenë testamentet të cilat lëshohen nga persona që i kërkojnë ato para vdekjes së tyre dhe kur gjendja e tyre shëndetësore kërkon që noteri të shkojë dhe në banesën e personit testamentar.

Në hetimin paraprak, noteri vazhdon gjithashtu rregullimet e menjëhershme, zbulon trashëgimtarin, sendet dhe borxhet e trashëgimlënësit. Nëse procedurat e trashëgimisë në këtë fazë nuk ndërpriten, noteri miraton procedura të mëtejshme. Gjatë procedurave, noteri e çon trashëgiminë në përfundimin e një marrëveshjeje, rregullon qiramarrjen plotësisht, rregullon vlerën e trashëgimisë dhe vepron në likuidimin e trashëgimisë nëse ka ndodhur.

1.4 Të drejtat dhe detyrat e noterit

Noteri ka për detyrë shërbimin e tij ta kryejë në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Noteri dhe personat që janë të punësuar te noteri nuk guxojnë të jenë përfaqësues të palëve dhe nuk guxojnë të ndërmjetësojnë gjatë lidhjes së punëve juridike apo në lidhje me to të japin garanci apo të japin sigurim tjetër palës.²³

Detyra e noterit është që në gjithë veprimtarinë e tij noteriale të respektojë e zbatojë ligjin me përpikmëri dhe pa e shkelur atë. Në të kundërt, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar shtetasit përkatës.

²³ Neni 29, Ligji për Noterinë në RM, Gazeta zyrtare nr.72 /2016

1.5 Refuzimi i marrjes së veprimit zyrtar

Sipas Ligjit për noterinë noteri është i detyruar që të ndërmerr të gjitha veprimet zyrtare nga kompetenca e tij e përcaktuar me ligj dhe nuk mundet pa shkak të arsyeshëm të refuzojë ndërmarrjen e veprimeve zyrtare. Noteri ka të drejtë dhe ka për obligim mos të pranojë veprimin zyrtar nëse ky nuk përputhet me detyrën e tij zyrtare, veçanërisht nëse pjesëmarrja e tij kërkohet për arritjen e qëllimeve të palejuara.

Noteri nuk guxon të marrë veprim zyrtar në të cilin merr pjesë personi për të cilin di apo doemos duhet të dijë se është i paaftë të marrë apo të lidhë punë të caktuara juridike.²⁴ Noteri do të refuzojë marrjen e veprimit zyrtar, nëse palët nuk kanë autorizim të rregullt në pajtim me rregullat me të cilat është rregulluar marrja e veprimit të tillë, si dhe nëse dokumente për punën juridike nuk përmban vulë të avokatit dhe nënshkrim, përkatësisht nuk është i pranishëm avokat në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Nëse noteri refuzon të marrë veprim zyrtar, me kërkesë me shkrim të palës, ai ka për detyrë në afat prej tri ditësh të miratojë aktvendim me shkrim me arsyetimin për shkaqet që refuzohet marrja e veprimit zyrtar. Kundër këtij aktvendimit, pala ka të drejtë ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Bordi Drejtues i Odës, i cili vendos në afat prej tetë ditësh nga pranimi i ankesës. Për konstatimet nga ankesa Bordi drejtues vendos me aktvendim, që dorëzohet te noteri kundër aktvendimit të të cilit është parashtruar ankesa dhe te pala që ka parashtruar ankesë.²⁵

1.6 Kompetencat dhe autorizimet e noterit

Noteri vepron në fusha të shumta. Ai është një specialist i përgjithshëm i drejtësisë i cili ka një vision global për problemet e natyrave të ndryshme juridike. Në përvojat e zakoneve noteriale nuk janë të rralla rastet kur thuhet se noteri me kënaqësi shprehet se roli i tij mund të definohet si një “mjek i pasurisë”.²⁶

Si një zyrtar publik, i caktuar për pranimin e akteve *inter vivos* (shitblerjes, këmbimit, dhurimit etj.) dhe të shprehjeve të vullnetit të fundit përmes akteve *mortis causa* (testamentet), duke i'u

²⁴ Paragrafi 3 neni 30, Ligji për Noterinë në RM, Gazeta zyrtare nr.72 /2016

²⁵ Neni 30, Ligji për Noterinë në RM, Gazeta zyrtare nr.72 /2016

²⁶ Lirim Begzati, “Noteria jone”, Arbëria Design 2010, faqe 21

dhënë atyre fuqinë publike, duke siguruar ruajtjen e tyre dhe lëshimin e kopjeve, çertifikatave dhe ekstrakteve, noteri mbanë në duart e tija kompetenca të shumta të vlerës madhore.

Kompetenca e noterëve përfshinë posaçërisht të gjithë atë çka ndërlidhet me familjen, pasurinë, ndërmarrjet e natyrave të ndryshme, të drejtën ndërkombëtare private, të drejtën e urbanizimit, të drejtën e konsumatorëve, të drejtën e detyrimeve, të drejtën fiskale, të drejtën hipotekore etj.

Sa i përket të drejtës familjare dhe trashëgmore, kjo është lëmia tradicionale e aktivitetit noterial (kontratat martesore, akt-dhurimet, testamentet, trashëgimitë, etj.).

Aktet noteriale të hartuara në pajtim me ligjin, kanë fuqinë e akteve autentike. Kuptimi i një akti autentik, është kuptimi i një akti ligjor, i pranuar nga palët si shprehje e vullnetit të tyre dhe i pakontestuar prej tyre dhe detyrimisht i respektueshëm dhe i zbatueshëm.

Pra, një akt noterial që të pranohet nga organet e institucionet shtetërore ose administrative e gjyqësore, kërkohet që të jetë në kushtet e parashikuara me ligj, i cili duhet të redaktohet pranë një zyre noteriale, për rrjedhojë ky akt ka fuqinë e një akti autentik.

1.7 Tiparet dhe fuqia e aktit noterial

Akti noterial është dokument shkresor i redaktuar ligjërisht nga noteri, i përpiluar në formën e caktuar juridike të përcaktuar me ligj dhe që në përmbajtjen përmban veprime të caktuara juridike të lidhura mes palëve pjesëmarrëse në këtë akt, të cilat sjellin pasojat ligjore të parashikuara e të dëshiruara prej tyre.²⁷

Akti noterial ka fuqi juridike më të lartë se çdo akt tjetër i kryer nga vetë personi. Prandaj në kuadrin ligjor ai është një akt që ka fuqinë e aktit autentik duke qenë se është i vetëm në llojin e vet. Por akti noterial duhet të plotësojë disa kushte që të konsiderohet i tillë. Së pari, ai duhet të jetë i nënshkruar në çdo faqe të tij nga palët dhe nga noteri vet, duhet të vuloset nga noteri. Së dyti noteri në përpilimin e aktit noterial nuk duhet kurrësi të mbajë anën e njëjës apo tjetrës palë. Së treti akti duhet të përpilohet pastërt gramatikisht, personat që kërkojnë një akt noterial

²⁷ Petraq Çuri, “E drejta procedurale civile & Noteria”, 2008, fq. 397

duhet të kenë zotësi të plotë për të vepruar, shpenzimet për aktin noterial do ti përballojnë të gjitha palët në mënyrë të barabartë.

Aktet noteriale kanë efekte preventive ndaj konflikteve lidhur me vërtetësinë apo vlefshmërinë e kontratave, marrëveshjeve, testamenteve apo çdo dokumenti tjetër që kërkon çertifikimin juridik të noterit për t'i dhënë atij vlerë juridike, të barazvlefshme me origjinalin. Parë nga ky këndvështrim themi se vula noteriale mbi një dokument apo akt noterial është çertifikimi juridik i rregullsisë së atij dokumenti dhe kjo është në funksion të një drejtësie të mirë dhe parandalimit të konflikteve, por si çdo profesion tjetër mund të kemi dhe shpërdorim detyre, që në fakt rastet e noterëve nuk janë shumë problematike në vendin tonë, por kjo pjesë i mbetet gjyqësorit.

1.7.1 Përmbajtja e aktit noterial

Akti noterial duhet të përmbajë:

- të dhënat për ditën, muajin dhe vitin, vendin, e kur me ligj kjo është paraparë ose pjesëmarrësit këtë e kërkojnë dhe orën kur është përpiluar akti;
- të dhënat (emri, mbiemri dhe selia zyrtare dhe rajoni) për noterin i cili e ka përpiluar aktin;
- të dhënat (emri, mbiemri, vendi dhe datëlindja, vendbanimi ose vendqëndrimi, numri unik i amzës, përkatësisht numri tjetër identifikues) për pjesëmarrësit. Nëse ndonjëri prej pjesëmarrësve ka të autorizuar, atëherë të dhënat e njëjta duhet të futen edhe për të, ndërsa autorizimi duhet të verifikohet, dhe t'i bashkëngjitet origjinalit të aktit në përshkrim origjinal ose të verifikuar;
- deklaratën për mënyrën në të cilën noteri e ka përcaktuar identitetin e pjesëmarrësve;
- përshkrimin e detajuar të lëndës së aktit. Kur lënda e aktit është patundshmëri shënohen të dhënat kadastrale për patundshmërinë. Nëse prona e patundshme gjendet në komunën kadastrale për të cilën nuk ka kadastër të organizuar të patundshmërive, e as nuk është bërë shënimi individual i të drejtave të patundshmërive, ndërsa prona nuk është evidentuar në kadastrën e tokës, shënohen të dhënat nga dokumentet për bazën juridike, në bazë të të cilit është fituar e drejta e patundshmërisë, që është lëndë e atij akti;²⁸

²⁸ Neni 65, Ligji për Noteri në RMV, gazeta zyrtare nr.72/2016

- shtojcat ndaj origjinalit të aktit në përshkrim origjinal ose të verifikuar. Si shtojcë e aktit konsiderohet dokumenti nga i cili noteri konstaton fakte relevante për përpilimin ligjor të aktit;
- shënimin se akti dhe shtojcat u janë lexuar ose është vepruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Leximi i shtojcave mund edhe të mos kryhet, nëse këtë e kërkojnë në mënyrë eksplicite të gjitha palët, dhe atë vetëm në raste kur ato dinë të lexojnë dhe shkruajnë, ndërsa kjo do të shënohet në vetë aktin;
- shënimi i numrit në listat dhe faqet;
- nënshkrimi i të gjithë pjesëmarrësve, e në fund nënshkrimi dhe vula e noterit. Nëse ndonjë prej pjesëmarrësve të aktit noterial nuk di ose nuk mund të nënshkruhet, duhet të shënohen shkaqet, ndërsa noteri atë ta shënojë dhe
- të dhënë për orën e nënshkrimit të testamentit.²⁹

²⁹ Neni 65, Ligji për Noteri në RMV, gazeta zyrtare nr.72/2016

1.8 Marrja e dokumentit, parave dhe letrave me vlerë për ruajtje dhe dorëzim

Noteri detyrohet që t'i marrë të gjitha llojet e dokumenteve, për ruajtje ose dorëzim. Noteri mund të refuzojë marrje të ndonjë dokumenti, nëse për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme.

Për marrjen e dokumenteve përpilohet procesverbal, në të cilin do të shënohet vendi dhe koha e marrjes, emri, mbiemri dhe adresa e personit i cili e ka dorëzuar dokumentin, shenja e dokumentit, arsye se përse është dhënë në ruajtje, afati i ruajtjes, afati i dorëzimit dhe kujt duhet t'i dorëzohet, nëse dokumenti është marrë në ruajtje për dorëzim. Procesverbalin do të nënshkruajë personi i cili e ka dorëzuar dokumentin dhe noteri. Në procesverbal noteri do ta vë vulën e tij. Noteri është i obliguar ta përcaktojë identitetin e personit të cilit ia dorëzon dokumentin në pajtim me nenin 57 të ligjit për noteri. Pranuesi i dokumentit të cilit i dorëzohet dokumenti, është i obliguar ta konfirmojë pranimin e dokumentit në procesverbalin për dorëzim.³⁰

Nëse noteri nuk mund ta realizojë dorëzimin e urdhëruar të dokumenteve në afatin e caktuar, është i obliguar pas skadimit të atij afati, pa prolongim t'ia kthejë palës dokumentet e marra. Për kthim të dokumentit për shkak të skadimit të afatit për ruajtje, noteri përpilon procesverbal për kthim, në të cilin do të shënohet vendi dhe koha e kthimit, emri, mbiemri dhe adresa e personit të cilit i kthehet dokumenti, shenja e dokumentit, si dhe shkaku për kthimin e dokumentit. Procesverbalin do ta nënshkruajë noteri dhe personi të cilit i kthehet dokumenti. Në procesverbalin noteri do ta vë edhe vulën e vet.³¹

³⁰ Neni 57, Ligji për Noteri në R.Maqedonisë së Veriut, gazeta zyrtare nr.72/2016

³¹ Neni 104, Ligji për Noteri në R. Maqedonisë së Veriut, gazeta zyrtare nr.72/2016

2 NOTERIA DHE E DREJTA TRASHËGIMORE

E drejta trashëgimore është një pjesë e drejtës civile që rregullon marrëdhëniet pasurore që rrjedhin me rastin e vdekjes së një personi, do të thotë rregullon transferimin e të drejtave dhe detyrimeve pasurore nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët e tij. Lënda e rregullimit të së drejtës trashëgimore është trashëgimia, që nënkupton transferimin e sendeve, të drejtave pasurore dhe detyrimeve nga trashëgimlënësi te trashëgimtarët e tij. Në atë kuptim, sipas Ligjit për Trashëgiminë mund të trashëgohen "objektet dhe të drejtat që u përkasin individëve".³² Trashëgimia ndodh në momentin e vdekjes së një personi, kur në të njëjtën kohë shuhet subjektiviteti i tij, dhe të drejtat dhe detyrimet e tij pasurore transferohen te trashëgimtarët. Bazuar në këtë, në mënyrë që të ndodhë një trashëgimi dhe formimi i një marrëdhënie trashëgimie, është e nevojshme që një person fizik që ka një trashëgimi të vdesë dhe të ketë trashëgimtarë që kanë një bazë ligjore të thirren për të trashëguar.

Vdekja është një fakt juridik. Me vdekjen e një personi marrëdhëniet e tij juridike nuk pushojnë, por pasuria e tij kalon te personat tjerë, e subjekte të tjera juridike. Pasuria e tillë që me vdekjen e njërit person kalon te personi tjetër quhet trashëgimi (*hereditas*); personi i cili vdes dhe vdekja e të cilit sjell institucionin e trashëgimisë quhet trashëgimlënës (*de cuius, defunctus*), ndërsa personat, tek të cilët kalon pasuria e tij quhet trashëgimtarë (*heres*).³³

Termi e drejta trashëgimore në teori dhe praktikë ka tre kuptime të ndryshme: e drejta trashëgimore objektive, e drejta trashëgimore subjektive dhe e drejta trashëgimore si shkencë. E drejta trashëgimore, si e drejtë objektive, nënkupton një tërësi normash dhe rregullimesh juridike që rregullojnë marrëdhëniet e trashëgimisë dhe rregullojnë transferimin e amanetit nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët e tij. E drejta e trashëgimisë pozitive është pjesë e së drejtës objektive të trashëgimisë e cila përbëhet nga norma dhe rregullore juridike që aktualisht janë në fuqi dhe zbatohen në një territor të caktuar.³⁴

³² Neni 2, Ligji mbi trashëgiminë(1996), gazeta zyrtare nr 47/96

³³ Dr.Borislav T. Blagojevic, Nasledno pravo, "Naucna knjiga", Beograd 1961, fq.4

³⁴ Angel Ristov & Dejan Mickovikj "Nasledno Pravo", 2020, fq. 17

E drejta e trashëgimisë si e drejtë subjektive nënkupton të drejtën e një ose më shumë personave të paraqiten si trashëgimtarë të të gjithë ose një pjesë të caktuar të pasurisë së të ndjerit në një rast specifik. Trashëgimtarët fitojnë të drejtën e tyre në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, bazuar në rregullat e parashikuara nga e drejta objektive trashëgimore. Deri në atë moment, trashëgimtarët e mundshëm nuk fitojnë një të drejtë subjektive të trashëgimisë, por ata kanë vetëm një shpresë ligjore (*emptio spei*) që ata do të bëhen trashëgimtarë në bazë të ligjit ose në bazë të një testamenti.

E drejta e trashëgimisë si shkencë është pjesë e shkencës juridike që studion, analizon dhe sistemon normat juridike që rregullojnë trashëgiminë, si dhe zbatimin e normave juridike në praktikë (*de lege lata*). E drejta trashëgimore si disiplinë shkencore studion të drejtën pozitive (të vlefshëm) në mënyrë që ta kuptojë dhe ta zbatojë më mirë atë. Në atë kuptim, shkenca përdoret me metoda të shumta, përfshirë normative-juridike, historike, krahasuese-juridike dhe të tjera. Përveç studimit, e drejta e trashëgimisë si shkencë, bazuar në metodën e analizës së problemeve në praktikë, si dhe zgjidhjeve juridike- krahasuese, synon të propozojë ndryshime dhe plotësime në rregulloren ekzistuese, në mënyrë që ta përmirësojë dhe modernizojë atë.³⁵

E drejta e trashëgimisë studion bazat juridike të trashëgimisë: me ligj dhe me testament, pra, normat pozitive ligjore, me të cilat rregullohet kalimi i pasurisë së trashëgimlënësit tek trashëgimtarët.

2.1 Trashëgimia

Trashëgimi hapet (*dellatio*) në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Të drejtat e vjetra kanë përcaktuar rregullën (*viveris non datur heredita*), i gjalli nuk trashëgohet.³⁶ Në momentin e hapjes së trashëgimisë trashëgimtarët e thirrur në trashëgimi fitojnë të drejtën e trashëgimisë. Në trashëgimtarë kalojnë vetëm ato të drejta dhe detyrime që trashëgimlënësi kishte në momentin e vdekjes së tij. Shpallja e personit të zhdukur si i vdekur barazohet me vdekjen faktike. Vdekja faktike vërtetohet me aktvdekje të lëshuar nga ofiqari, ndërsa vdekja e personit të shpallur si i

³⁵ Angel Ristov & Dejan Mickovikj “Nasledno Pravo”, 2020, fq. 18.

³⁶ <https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/722/20173110-bd61-4aa4-9ad5-a095d9231870.pdf?sequence=4&isAllowed=y>

vdekur me aktvendim të gjykatës. Në kohën e hapjes së trashëgimisë përcaktohet edhe rrethi i trashëgimtarëve ligjor dhe me testament. Lidhet juridikisht momenti i parashkrimit të kërkesës për zvogëlimin e disponimeve me testament.³⁷

Sipas ligjit tonë të trashëgimisë, një fëmijë i ngjizur pas vdekjes së trashëgimlënësit (post mortum) nuk ka të drejtë të trashëgojë. Neni 122 i Ligjit për Trashëgiminë përcakton se trashëgimtarë mund të jetë vetëm një person i cili është i gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, ose që është ngjizur gjatë jetës së trashëgimlënësit. Për shkak faktit se të riprodhimi artificial post human, fëmija është ngjizur pas vdekjes së trashëgimlënësit, ai nuk mund të shfaqet si trashëgimtarë.

Një dispozitë duhet të futet në Ligjin për Trashëgiminë, i cili do të sigurojë të drejtën e trashëgimisë së fëmijëve të fekonduar pas vdekjes (post human). Para se gjithash, ligjvënësi ka dy mundësi. E para është të pritët me shqyrtimin e trashëgimisë nëse testatori ka dhuruar spermë dhe ka bërë një deklaratë me shkrim se ai dëshiron që partneri të fekondohet pas vdekjes brenda dy ose më së shumti tre vjet. Mundësia e dytë është të rezervohet një pjesë për fëmijën që mund të lindë dhe pjesa tjetër të shpërndahet tek trashëgimtarët e tjerë. Nëse fëmija ka lindur brenda periudhës së përcaktuar ligjërish, ai do të bëhet trashëgimtar. Përndryshe, pjesa e tij do të ndahet midis trashëgimtarëve të tjerë. Në çdo rast, zgjidhja aktuale ligjore, e cila nuk parashikon mundësinë që një fëmijë i ngjizur dhe i lindur pas vdekjes së prindit të bëhet trashëgimtar, është diskriminuese dhe e papranueshme. Nevoja për trajtim të barabartë të të gjithë fëmijëve dhe kujdesi për të realizuar të drejtat dhe interesat e fëmijëve kërkon në mënyrë imperative ndryshime të duhura në Ligjin për Trashëgiminë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.³⁸

2.1.1 Trashëgimia me ligj

Trashëgimia me ligj është kalim me ligj i pasurisë së personit të vdekur, tek një apo më shumë persona sipas rregullave të caktuara ligjore.³⁹ Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur

³⁷ Refik Mustafa “E drejta trashëgimore- Pyetje dhe përgjigje” e marrë nga <https://www.slideshare.net/refiku/e-drejta-trashgimore-pyetje-prgjigje>

³⁸ Prof.Dr Dejan Mickovikj „Reproduksioni post-human dhe e drejta trashëgimore“ 2010, faqe 541

³⁹ E Drejta Trashëgimore - Pyetje & Përgjigje - <https://www.slideshare.net/refiku/e-drejta-trashgimore-pyetje-prgjigje>

testamenti është tërrësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.⁴⁰ Pra, me këtë nënkuptojmë se trashëgimia me ligj zbatohet vetëm kur: mungon testament; kur me anë të testamentit është disponuar vetëm një pjesë e pasurisë; kur testamenti është plotësisht i pavlefshëm apo kur testamenti është pjesërisht i pavlefshëm.

Përmbajtja e masës trashëgimore:

- llojet e ndryshme të sendeve që të mund të barten në pronësi ose posedim
- të drejtat sendore (e drejta e pronësisë, e pengut, e servituteve, posedimi, etj)
- të drejtat e detyrimeve (kontrata e shitblerjes, shpërblimi i dëmit, pasurimi pa bazë, depozita, premitë e sigurimeve, etj)
- të drejtat trashëgimore (transmisioni trashëgimorë)
- të drejtat nga pronësia industriale - trashëgohet vetëm komponenta materiale e këtyre të drejtave
- obligimet e trashëgimlënësit – vetëm obligimet pasurore

Të drejtat dhe obligimet që nuk janë pjesë e masës trashëgimore:

- Të drejtat personale (e drejta e emrit, nderit, dinjitetit)
- Të drejtat familjare me karakter personal
- Obligimet *intuitu personae* (p.sh obligimi për të shkruajtur një këngë, punimi i një portreti, etj)
- Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Rendi i parë i trashëgimisë ligjore përbëhet nga pasardhësit e trashëgimlënësit (fëmijët martesorë dhe jashtëmartesorë), i adoptuari, nipërit/mbesat, stërnipërit/stërmbesat dhe bashkëshorti. Trashëgojnë si fëmijët e përbashkët legjitim dhe fëmijët e përbashkët ilegjitim. Të gjithë trashëgimtarët trashëgojnë një pjesë të barabarta.


Në radhën e parë të trashëgimisë ligjore aplikohet e drejta e përfaqësimit dhe e drejta e shtimit.

⁴⁰ E Drejta Trashëgimore - Pyetje & Përgjigje - <https://www.slideshare.net/refiku/e-drejta-trashgimore-pyetje-prgjigje>

Me të drejtën e përfaqësimit kuptojmë kur pasardhësi paraqitet me zëvendësim në vend të paraardhësit, në kuadër të një vije zbritëse dhe trashëgon atë pjesë të trashëgimisë që do ta kishte trashëguar paraardhësi i tij sikur të kishte qenë gjallë.

Me të drejtën e shtimit zbatohet kur pjesa e një apo më shumë trashëgimtarëve mbetet e lirë, kur e drejta e përfaqësimit nuk mund të zbatohet. Shembull: Nëse trashëgimlënësi ka vdekur dhe pas vetës ka lënë dy fëmijë. Nëse njëri prej fëmijëve ka vdekur para trashëgimlënësit dhe pas vetës nuk ka lënë pasardhës atëherë pjesën që do ta trashëgonte ky do ta trashëgojë fëmija tjetër ose gjithë pasurinë.

Figure 1: -Rendi i parë i trashëgimisë ligjore




Në rendin e dytë të trashëgimisë ligjore trashëgojnë dy prindërit, bashkë $\frac{1}{2}$, kurse secili veç e veç nga $\frac{1}{4}$, dhe bashkëshorti vetëm $\frac{1}{2}$.

Edhe këtu zbatohet e drejta e shtimit dhe e përfaqësimit.


Figure 2:-Rendi i dytë i trashëgimisë ligjore

⁴¹ Arta Selmani-Bakiu “Sistemet juridike- trashëgimore bashkëkohore”, 2019




42

Figure 3: E drejta e përfaqësimit në rendin e dytë të trashëgimisë ligjore



43 E drejta e përfaqësimit.

Figure 4: E drejta e shtimit në rendin e dytë të trashëgimisë ligjore



44 E drejta e shtimit


⁴² Arta Selmani-Bakiu “Sistemet juridike- trashëgimore bashkëkohore”, 2019

⁴³ Arta Selmani-Bakiu “Sistemet juridike- trashëgimore bashkëkohore”, 2019

⁴⁴ Arta Selmani-Bakiu “Sistemet juridike- trashëgimore bashkëkohore”, 2019


Në rendin e tretë të trashëgimisë formohen dy trungje; trungu i atësisë dhe trungu i amësisë. Secili trung trashëgon nga $\frac{1}{2}$. Ndërsa secili gjysh apo secila gjyshe trashëgon nga $\frac{1}{4}$. Edhe këtu zbatohet e drejta e shtimit dhe e drejta e përfaqësimit. Në radhën e tretë trashëgojnë vetëm trashëgimtarët e thirrur në trashëgimi sipas faktit të gjinisë së gjakut.⁴⁵

Figure 5: Rendi i tretë i trashëgimisë ligjore



46

Figure 6: E drejta e përfaqësimit në rendin e tretë të trashëgimisë ligjore



47

⁴⁵ Neni 20, Ligji mbi trashëgiminë i RMV, gazeta zyrtare 47/96

⁴⁶ Arta Selmani-Baku "Sistemet juridike- trashëgimore bashkëkohore", 2019

⁴⁷ Arta Selmani-Baku "Sistemet juridike- trashëgimore bashkëkohore", 2019

2.1.2 Trashëgimia me testament

Testamenti është veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të cilit ky disponon pasurinë në kohën pas vdekjes. Testamenti është deklaratë e fundit e vullnetit, e njëanshme, personale, e personit me zotësi testamentare, e rregulluar me ligj, me të cilën disponon pasurinë pas vdekjes së tij, jep urdhëresa të tjera dhe deklarata lidhur me pasurinë e tij.⁴⁸

Llojet e testamentit:

- **Testamenti ollograf-** Testamenti është i plotëfuqishëm nëse testamentlënësi e ka shkruar me dorën e vet dhe atë e ka nënshkruar⁴⁹
- **Testamenti me gojë**– testamentlënësi mund të deklaroj vullnetin e tij të fundit gojarisht para dy dëshmitarëve, vetëm nëse përshkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk ka mundësi të përpilojë testament të shkruar⁵⁰
- **Testamenti gjyqësor** - Testamentin e testamentlënësit, sipas deklarimit të tij verbal, mund ta përpilojë gjykatësi i gjykatës themelore, i cili paraprakisht do të vërtetojë identitetin e testamentlënësit⁵¹
- **Testamenti diplomatik-konsullor** – është i plotëfuqishëm testamenti i përgaditur nga shtetasi i Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit sipas dispozitave që vlejné për përgaditjen e testamentit gjyqësor nga ana e përfaqësuesit konsular apo diplomatik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili kryen punë konsulare.⁵²

⁴⁸ Antic, B. Oliver, “Nasledno pravo”, 2010, faqe 187

⁴⁹ Neni 66 paragrafi 1 I Ligjit mbi trashëgiminë i RMV, Gazeta zyrtare nr.47/96

⁵⁰ Neni 90, Ligjit mbi trashëgiminë i RMV, Gazeta zyrtare nr.47/96

⁵¹ Neni 67, Ligjit mbi trashëgiminë i RMV, Gazeta zyrtare nr.47/96

⁵² Neni 72, po aty

- **Testamenti ndërkombëtar**- është i plotëfuqishëm në aspektin e formës, pa marrë parasyshë vendin ku është përpiluar, ku gjendet pasuria, shtetësia apo vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i testamentlënësit.⁵³
- **Testamenti ushtarak**– mund të bëhet vetëm gjatë luftës ose mobilizimit.

Testamenti në formë të aktit noterial përpilohet në pajtim me dispozitat nga Ligji për procedurë jashtëkontestimore që vlejné për përpilimin e testamentit gjyqësor.⁵⁴ Noterit të cilit i është dorëzuar ose te i cili ruhet testamenti, kur do të vërtetohet përpiluesi i tij se është i vdekur ose i shpallur si i vdekur, është i detyruar ta hapë testamentin, pa mos e prishur vulën, ta lexojë dhe për këtë të përpilojë procesverbal. Me këtë testamenti është i shpallur. Hapja dhe leximi i testamentit kryhet në prani të dy qytetarëve të moshës madhore, të cilët mund të jenë edhe nga radhët e pasardhësve. Gjatë shpalljes së testamentit mund të marrin pjesë pasardhësit, trashëgimtarët dhe personat e tjerë të interesuar dhe të kërkojnë kopje nga testamenti, përkatësisht nga procesverbali për shpalljen e testamentit. Noteri, te i cili testamenti ndodhet ose të cilit i është dorëzuar, do ta shpallë testamentin edhe përkundër asaj që për shqyrtimin e trashëgimisë është kompetente gjykata tjetër ose organ i huaj.⁵⁵

2.1.3 Pavlefshmëria e testamentit

Të pavlefshme janë dispozitat e testamentit me anë të cilave i caktohet pjesë nga masa trashëgimore gjykatësit i cili e ka përpiluar testamentin, procesverbalistit apo dëshmitarëve, si dhe paraardhësve, pasardhësve, vëllezërve, motrave dhe bashkëshortëve të këtyre personave.⁵⁶

Ekzistojnë tri shkaqe kryesore që si pasojë kanë pavlefshmërinë e testamentit:

- a) Kërcënimi
- b) Dhuna dhe
- c) Mashtrimi⁵⁷

⁵³ Neni 74, Ligjit mbi trashëgiminë i RMV, Gazeta zyrtare nr.47/96

⁵⁴ Neni 67, Ligji për Noteri I RMV-së, gazeta zyrtare nr.72/16

⁵⁵ Neni 156, Ligji për procedurë jashtëkontestimore i RMV-së, Gazeta Zyrtare nr.09, 2008

⁵⁶ Neni 71, Ligji për Noteri I RMV-së, gazeta zyrtare nr.72/16

Disponimet me testament janë nule edhe kur ekziston lajthim për faktet që kanë nxitur testamentlënësin t'i bëjë këto disponime. Nëse vetëm disa dispozita të testamentit janë përpiluar nën kërcënim ose dhunë, për shkak mashtrimit ose në lajthim, atëherë vetëm ato janë nule.

2.1.3.1 Testamenti absolut nul

Testamenti absolut nul konsiderohet se është nëse dispozitat e tij janë në kundërshtim me dispozitat imperative ligjore, me rendin juridik dhe me rregullat e moralit. Në varësi nga intesiteti i paraqitjes, sipas doktrinës juridike, edhe kanosja, shtrëngimi, mashtrimi dhe lajthitja mund të përbëjnë shkakun absolut të nulitetit të testamentit. Gjykata ka të drejtë të kujdeset ex officio për shkaqe absolute të nulitetit të testamentit dhe në ato mund të thirret çdo person i interesuar, duke qenë se ato çënojnë interesat e përgjithshme shoqërore.⁵⁸

2.1.3.2 Testamenti relativ nul

Testamenti është relativ nul nëse shkaqet e nulitetit e çënojnë vetëm interesat e individëve të caktuar. Për shkaqet e nulitetit relativ gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare siç është tek shkaqet absolute të nulitetit, por personat, interesat e të cilëve janë çënuar, mund të kërkojnë vetë nulitetin e testamentit. Edhe kur ekzistojnë shkaqet relative të pavlefshmërisë, testamenti mund të mbetet në fuqi dhe të prodhojë efekte juridike, nëse personat e interesuar nuk paraqesin padi për nulimin para gjykatës.⁵⁹

2.1.4 Kontrata mbi ndarjen dhe bartjen e pasurisë gjatë jetës së trashëgimlënësit– Cedimi

Cedimi dhe ndarja e pasurisë për së gjalli është veprim të cilin e ndërrmer paraardhësi (trashëgimlënësi) në pajtim me të gjithë trashëgimtarët e vet. Kjo mënyrë e rregullimit të raporteve pronësore konsiderohet e lejueshme dhe e vlefshme nëse kryhet në pajtim me ligjin. Për të qenë cedimi dhe ndarja e vlefshme duhen plotësuar dy kushte:

⁵⁷ Hamdi Podvorica, “E drejta trashëgimore”, 2006, faqe 112

⁵⁸ Antic, B. Oliver, “Nasledno pravo”, faqe 302

⁵⁹ Hamdi Podvorica “E drejta trashëgimore”, 2006, faqe 115

1) pëlqimi i të gjithë trashëgimtarëve dhe 2) marrëveshja me shkrim e vërtetuar në gjyq.

Objekti i kontratës është pasuria e ceduesit në momentin e lidhjes së kontratës.

E rëndësishmja e këtij lloji të kontratës është se :

1. trashëgimtarët fitojnë trashëgiminë gjatë jetës së trashëgimlënësit (*inter vivos*)
2. nëse trashëgimlënësi nuk është në gjendje të disponojë me pasurinë e tij, e bartë tek trashëgimtarët të cilët janë në gjendje më mirë të disponojnë me pasurinë
3. autoriteti i trashëgimlënësit dhe dëshira e tij për ndarjen e pasurisë parandalon konfliktet eventuale lidhur me pasurinë mes pasardhësve

Palët kontraktuese janë:

- paraardhësi dhe fëmijët e tij, - rendi i parë ligjorë i trashëgimisë
- bashkëshorti/ja- nëse jep pëlqimin; nëse nuk jep pëlqimin, ruan të drejtën për pjesën e domosdoshme të trashëgimisë⁶⁰

2.2 Vdekja e personit

2.2.1 Aktvdekja

Aktvdekja është dokumenti ligjor që përcakton trashëgimtarët e mundshëm dhe për këtë arsye është e rëndësishme që të iniciohet ligjrisht procedurë trashëgimore. Aktvdekjen e përpilon ofiqari, i cili është kompetent për regjistrimin e personit të vdekur në librin amzë të të vdekurve.

Aktvdekja përpilohet çdoherë kur ndonjë person vdes ose është shpallur si i vdekur, pa marrë parasysh nëse ka ose nuk ka pronë. Aktvdekja përpilohet në bazë të të dhënave të marra nga familjarët e të vdekurit, nga personat me të cilat i vdekuri ka jetuar, si dhe nga persona tjerë të cilët mund të japin të dhëna që do të futen në aktvdekje.⁶¹

⁶⁰ Neni 1027, Ligji i marrëdhënieve detyrimore i RM, Gazeta Zyrtare nr.18/2001.

⁶¹ Neni 144, Ligji i procedurës jashtëkontestimore i RMV, Gazeta Zyrtare nr.09, 2008.

Aktvdekja i përmban këto të dhëna:

- emrin, emrin e babës dhe mbiemrin e të vdekurit, ndërsa për të vdekurit persona të gjinisë femërore -edhe mbiemrin e vajzërisë, profesionin e të vdekurit, datëlindjen e tij, shtetësinë;
- ditën, muajin dhe vitin, dhe sipas mundësisë dhe orën e vdekjes dhe vendin e vdekjes;
- vendin në të cilin i vdekuri ka jetuar, përkatësisht vendqëndrimin;
- mbiemrin dhe emrin, datëlindjen, profesionin, vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin e bashkëshortit të të vdekurit dhe të fëmijëve të tij;
- mbiemrin dhe emrin, datëlindjen dhe vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin e familjarëve tjerë dhe personave të cilët do të mund të thirren në trashëgimi në bazë të ligjit, si dhe të personave të cilat janë thirrur në trashëgimi në bazë të testamentit;dhe
- vlefshmërinë e përafërt të pronës së patundshme dhe të tundshme të të vdekurit.⁶²

Në aktvdekje, sipas mundësive, futen të dhëna edhe për vendin ku gjendet prona që e ka lënë i vdekuri, nëse ka pronë për mbajtjen, ruajtjen dhe lajmërim e së cilës ekzistojnë dispozita të posaçme, nëse ka të holla të gatshme, letra me vlerë, gjëra të vlefshme, librezat kursimi ose dokumente tjera të rëndësishme, a ka lënë i vdekuri borxhe dhe sa, a ka lanë testament me shkrim ose marrëveshje për mbajtje të përzetshme ose marrëveshje për heqje dorë ose rindarjen e pronës gjatë jetës edhe ku ata ndodhen, nëse i vdekuri ka bërë testament me gojë, atëherë edhe mbiemri dhe emri, profesioni dhe vendqëndrimi i dëshmitarëve para të cilëve është bërë ai testament. Në aktvdekje në mënyrë të veçantë shënohet nëse pritet lindja e fëmijës së të vdekurit, si dhe ajo nëse fëmijët e tij ose bashkëshorti kanë tutor. Nëse para trashëgimlënësit ka vdekur bashkëshorti i tij, fëmija i tij, ose person tjetër i cili do të ishte thirrur në trashëgimi, në aktvdekje do të shënohet vendi dhe data e vdekjes së tyre.⁶³

⁶² Neni 145 , Ligji i procedurës jashtëkontestimore i RMV-së, Gazeta Zyrtare nr.09, 2008

⁶³ Neni 145, Ligji për procedurë jashtëkontestimore i RMV-së, Gazeta Zyrtare nr.09, 2008

3 PROCEDURA TRASHËGIMORE SIPAS LEGJISLACIONIT POZITIV TË RMV-SË

Në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë gjyqi i përcakton trashëgimtarët e të vdekurit, pronën të cilën e përbën trashëgimia e tij dhe të drejtat nga trashëgimia që u takojnë pasardhësve, trashëgimtarëve dhe personave tjerë.⁶⁴ Procedura për shqyrtimin e trashëgimisë ngrihet me detyrë zyrtare, menjëherë mbasi të njoftohet gjyqi për vdekjen e personit ose se personi është shpallur i vdekur.⁶⁵

Nxjerrjen e dëshmimeve dhe marrjen e deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia e kryen gjykatësi me procesverbalmbajtës. Deklaratat dhe propozimet tjera nga pjesëmarrësit mund t'i marrin në procesverbal edhe bashkëpunëtorët profesionalë me procesverbalmbajtës.

Procesverbalin e nënshkruajnë pjesëmarrësit që kanë marrë pjesë në veprimet në procedurë, gjykatësi përkatësisht këshilltari gjyqësor, dhe procesverbalmbajtësi.⁶⁶

Në rastet kur me aktvendim janë caktuar masat për sigurimin e trashëgimisë, ndërsa për shkak të prolongimit ekziston rrezik që zbatimi i atyre masave të pengohet, gjyqi mund të vendosë që ankesa të mos e ndalojë zbatimin e aktvendimit.⁶⁷

Çdo pjesëmarrës në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë i bart shpenzimet që i ka pasur gjatë ose me rastin e procedurës. Nëse ka pasur shpenzime të përbashkëta, gjyqi do të përcaktoj në ç'përmasë pjesëmarrësit do t'i bartin shpenzimet. Me propozimin e pjesëmarrësit, gjyqi mund të vendosë që edhe pjesëmarrësit tjetër t'ia kompensojë shpenzimet, nëse ato shpenzime janë shkaktuar qartazi me veprim pa vetëdije.⁶⁸

Pjesëmarrësit në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë janë: pasardhësit dhe trashëgimtarët dhe personat tjerë të cilët realizojnë ndonjë të drejtë të trashëgimisë.⁶⁹

⁶⁴ Neni 120, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁶⁵ Neni 121, po aty.

⁶⁶ Neni 122, po aty.

⁶⁷ Neni 123, po aty.

⁶⁸ Neni 124, po aty.

⁶⁹ Neni 125, po aty

Për shqyrtimin e trashëgimisë qytetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me pronën e tij, e cila gjendet në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekskluzivisht është kompetent gjyqi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht noteri si përfaqësues i gjykatës.

Gjykata mund t'ia besojë noterit zbatimin e procedurës së trashëgimisë dhe do t'ia dorëzojë lëndën e trashëgimisë me të gjitha shënimet, në afat prej 8 ditësh nga dita kur lënda do të regjistrohet. Kur noteri zbaton veprime në procedurën trashëgimore si përfaqësues i gjykatës, është i autorizuar t'i ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurën dhe t'i marrë të gjitha vendimet përveç atyre për të cilat me këtë ligj është përcaktuar ndryshe. Gjyqi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ekskluzivisht është kompetent për shqyrtimin e trashëgimisë së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me pronën e tij të luajtshme që gjendet jashtë vendit, kurse në lidhje me pronën e tij të patundshme e cila gjendet jashtë vendit, do të jetë kompetent vetëm nëse sipas ligjeve të shtetit në të cilin gjendet prona nuk është kompetent organi i huaj.⁷⁰

Kundërshtimin jo në kohë, jo të plotë ose kundërshtimin e palejuar, gjyqi e hedhë poshtë.

Duke vendosur për kundërshtimin kundër aktvendimit që e ka miratuar noteri, gjyqi në tërësi ose pjesërisht aktvendimin mund ta vërtetojë ose ta anulojë. Kur gjyqi aktvendimin pjesërisht do ta anulojë ose pjesërisht do ta vërtetojë, vetë do të vendosë për pjesën e anuluar të aktvendimit.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin aktvendimi i noterit në tërësi ose pjesërisht është anuluar, lejohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi i aktvendimit të shkallës së parë.

Aktvendimi pas kundërshtimit u dorëzohet pjesëmarrësve dhe noterit. Ndaj aktvendimit të noterit kundër të cilit është deklaruar kundërshtimi, ndërsa gjyqi e ka hedhur poshtë, klauzolën për plotfuqishmëri e vendos gjyqi që vendos për kundërvajtjen. Aktvendimi i noterit kundër të cilit nuk është deklaruar kundërshtim është i plotfuqishëm. Klauzolën për plotfuqishmërinë e këtij aktvendimi e vë noteri.⁷¹

Për shqyrtimin e trashëgimisë kompetent vendor është gjyqi në rajonin e se cilit trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanim të përhershëm, përkatësisht vendqëndrim (gjykatë trashëgimore). Nëse trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shqyrtimin e trashëgimisë kompetent

⁷⁰ Neni 126, Ligji për procedurë jashtëkontestimore të RMV, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁷¹ Neni 128, po aty

vendor është gjyqi në rajonin e të cilit trashëgimlënësi ka trashëgimi, ndërsa trashëgimtarët e tij kanë dorëzuar kërkesë për ngritjen e procedurës trashëgimore. Nëse asnjë pjesë e trashëgimisë nuk ndodhet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjyqin kompetent vendor e përcakton Gjyqi Suprem i Republikës së Maqedonisë së Veriut.⁷²

3.1 Fillet e zhvillimit të procedurës trashëgimore nga noterët.

Duke filluar në mesin e reformës së sistemit gjyqësor në shoqërinë bashkëkohore rumune, nevoja për të identifikuar mjete të reja alternative ligjore për të vlerësuar të drejtat subjektive të njerëzve, përveç atyre të ofruara nga gjykatat e ligjit, është një garanci e vërtetë që siguron sfondi optimal ligjor për harmonizimin e interesit individual me atë kolektiv. duke qenë në të njëjtën kohë, një instrument efikas i drejtësisë. Kështu, koncepti i "drejtësisë përtej gjykatave" bëhet një objektiv kryesor dhe jo vetëm një dëshirë e thjeshtë brenda një sistemi legjislativ i cili theksohet nga shteti i ligjit. Duke u nisur nga hipoteza në të cilën të drejtat civile subjektive mund të ushtrohen dhe mbrohen me mjete jo të diskutueshme, ligjvënësi rumun rregulloi kalimin e trashëgimisë së një personi të trashëgimtarët e tij me anë të procedurës së testamentit noterial. Për këto arsye, procedura e testamentit të noterisë është një procedurë e hijshme, me karakter jokontestues.⁷³

Ngarkimi i gjykatave me lëndë të cilët nuk janë kontestuese është i madh. Kjo e ngadalëson zgjedhjen e tyre si dhe të lëndëve tjera të karakterit kontestues. Pasi që proceset integruese përveç kërkesave dhe reformave tjera, kërkojnë edhe reforma në sferën gjyqësore e sidomos këmbëngulin në zgjedhjen sa më të shpejtë të lëndëve dhe sigurimin sa më të shpejtë të dhënies të mbrojtjes juridike subjekteve procedurale. Prosesi i shkarkimit të gjykatave nga lëndët jokontestuese nuk ka tendencë të ndaloj. Ky proces ka filluar që nga viti 1996 me nxjerjen e ligjit të parë për noterinë dhe si e tillë vazhdon edhe sot.

⁷² Neni 129, Ligji për procedurë jashtëkontestimore të RMV, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁷³ Cristinel Ioan Murzea "The notary testamentary procedure- a form of justice which goes beyond the court of law" ,2015, faqe 3

Definitivisht me nxjerjen e Ligjit të ri për procedurë jokontestimore ne vitin 2008 u bë e mundshme kalimi i autorizimeve nga gjykata tek noterët si "të besuar të gjykatës " të cilët noterë bënë pjesë në rajonin e gjykatës e cila ia beson lëndën të njëjtit.⁷⁴ Me këtë rast u krijua edhe mundësia juridike e kalimit të lëndëve trashëgimore nga kryetari i gjykatës themelore tek noteri.

Para sjelljes të Ligjit për procedurë jokontestimore të vitit 2008 pasurinë trashëgimore e shqyrtonte gjykatësi i vetëm i Gjykatës themelore, pa mar parasysh se a egzistonte kontesti apo jo ndërmjet subjekteve procedural, apo lidhur me atë se kush janë trashëgimtarë, kontest për pronën e cila është pjesë e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit apo për pjesët që u takojnë trashëgimtarëve. Me Ligjin për procedurë jokontestimore të vitit 2008 u krijuan kushtet për dhënien e vendimeve kualitative dhe zgjedhjen më të shpejtë të lëndëve trashëgimore kontestuese në njërën anë dhe atyre jokontestuese në anën tjetër. Në këtë mënyrë përveç se në të ardhmen do të sigurohet zgjidhja më e shpejtë dhe më kualitative e lëndëve, gjithashtu do të zvogëlohet numri i lëndëve të pazgjedhura.

Janë disa rregulla të "lojës" të cilat noteri duhet t'i ndjek që të mundet që në mënyrë të plotfuqishme t'a përfundoj procedurën e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore. Rregulli themelor i cili është i paraparë edhe në Ligjin për procedurë jokontestimore dhe sipas të cilit noteri duhet që gjithmonë të veproj është se të gjitha veprimet të cilat duhet t'i ndërmer noteri në procedurë si dhe vendimet të cilët ai duhet t'i sjellë në ato raste duhet të jenë në përputhje me ligjin respektivisht me Ligjin për procedurë jokontestimore.⁷⁵ Detyra e parë e tij është kontrolli i plotfuqishmërisë së aktvdekjes e cila ka të bëjë me kontrollin e aktvdekjes si dokument publik në aspektin e kompletueshmërisë së saj, pra se a është aktvdekja e plotë apo jo. Në qoftë se aktvdekja i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme, noteri do të vazhdoj me procedurën. Por në shumicën e rasteve noterit i paraqiten aktvdekje jo te kompletuara, e në disa raste vetëm çertifikata të librit amzë të të vdekurve. Në këto raste noterit i ngel të veproj në dy mënyra: vet t'a kompletoj apo t'a përpiloj aktvdekjen nëse ka një të tillë apo kompletimin apo përpilimin e aktvdekjes t'ia besoj ofiqarit kompetent. Nga praktika e përditshme e noterëve, vërehet se në shumicën e rasteve ato vet e kompletojnë aktvdekjen jo të plotë apo e përpilojnë një të tillë në rastë të mungesës së saj me qëllim të vazhdimit sa më të shpejtë të procedurës. Kompletimin e

⁷⁴ Neni 131, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, gazeta zyrtare nr. 09/2008

⁷⁵ Neni 132, Ligji për procedure jokontestimore, gazeta zyrtare nr. 09/2008

një aktvdekje apo përpilimin e tillë të njejtës, noteri e bën në bazë të të dhënave të fituara nga ana e familiarëve dhe të afërmeve të të vdekurit. Në këto raste noteri gjithmonë duhet të jetë i kujdesshëm në atë se të dhënat a janë apo nuk janë të sakta si dhe identike me të dhënat e dokumenteve të paraqitura bashkë me aktvdekjen, " duke i mar si relevante dhe të besueshme të dhënat për të vdekurin nga libri amzë i të vdekurve ".⁷⁶

Hap tjetër gjithashtu i rëndësishëm është edhe kontrolli i kompetencës vendore të gjykatës trashëgimore nga ana e noterit. Gjatë kontrollit të kompetencës vendore të gjykatës trashëgimore, noteri gjithmonë merr parasysh dhe mbështetet në nenin 129 e cila ka të bëjë me vendbanimin respektivisht vendqëndrimin⁷⁷ e trashëgimlënësit në momentin e vdekjes së tij apo të vendit në të cilin trashëgimlënësi ka pasurinë e tij të kundshme apo të patundshme.

Si veprim tjetër mjaft i rëndësishëm i cili ndërmiret nga ana e noterit në procedurën shqyrtimit të pasurisë trashëgimore dhe të cilat korenspondojnë me " parimin e socialitetit " si një ndër parimet më të rëndësishme të procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore është mbrojtja e veçantë e cila u jepet personave të veçantë në procedurë. Në grupin e personave të veçantë bëjnë pjesë personat e mitur të cilat nuk mundën që të kujdesen për të drejtat e tyre të cilat të drejtat dalin nga pasuria trashëgimore, personi i cili nuk ka prindër si dhe në qoftë se pritet lindja e një fëmije i cili do të mundet të thiret si trashëgimtarë.⁷⁸

3.1.1 Seanca për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Sipas nenit 167 të Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, noteri atëherë kur e konsideron të nevojshme apo kur atë e kërkon njëri nga personat të thirur në trashëgimi (trashëgimtarët, legatët, apo persona të tretë), do të " caktoj seancë " ⁷⁹. Seanca e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore gjithmonë fillon me " ftesë " ⁸⁰. Ftesa u dorëzohet të gjitha personave të cilët në një mënyrë apo tjetër kanë interes për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të të ndjerit. Sipas Ligjit për procedurë jokontestimore dhe Ligjit për procedurë kontestimore në ftesë duhet të shënohen të

⁷⁶ Stoeb Fidanco, "Pozicioni dhe kompetencat e noterit si i besuar i gjykatës në procedurë trashëgimore", notarius nr.11, faqe 13

⁷⁷ Neni 129, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, gazeta zyrtare nr. 09/2008

⁷⁸ Neni 164, po aty.

⁷⁹ neni 167 , po aty

⁸⁰ al. 2 neni 167, po aty

gjitha të dhënat e personit të ftuar në procedurë (trashëgimlënësit), të dhënat lidhur me adresën e zyrës të noterit si dhe dita dhe koha e mbajtjes së seancës. Noteri në ftesën për seancë sipas nenit 167 të Ligjit për procedurë jokontestimore është i obliguar që t'ua potencoj të ftuarve respektivisht trashëgimtarëve që në qoftë se trashëgimlënësi ka lënë para vdekjes apo ka përpiluar testament, t'a dorëzojnë të njëjtën në formë të shkruar, respektivisht ta dorëzojnë dokumentin në të cilën është regjistruar testamenti gojor ose t'i lajmërojnë dëshmitarët e testamentit gojor. Noteri në ftesën për pjesmarje në seancë do t'i njoftoj pjesmarësit procedural që deri në përfundimin e procedurës mundet të japin deklaratë lidhur me pranimin gjegjësisht heqjen dorë nga marja pjesë në ndarjen e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit.

3.2 Noteri si i besuar i gjykatës

Noterët, si përfaqësues gjyqësor, ndërmarrin veprime dhe marrin vendime në procedurën trashëgimore në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurë jokontestimore. Gjyqi nga disa shkaqe të rëndësishme, siç janë: pamundësia për veprim të noterit për shkak të sëmundjes ose shkaqe tjera, për shkak të mosrespektimit të dukshëm të veprimeve zyrtare, si dhe për shkak të arsyeve tjera në bazë të vlerësimit të gjykatës, mund ta ndërmarrë nga noteri zbatimin e mëtutjeshëm të procedurës trashëgimore, dhe procedurën vetë ta zbatoj ose t'ia besojë noterit tjetër.⁸¹

Noteri punët e besuara në procedurën trashëgimore i kryen në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurë jashtëkontestimore. Në procedurën që mbahet para noterit, pjesëmarrësi mund të përfaqësohet në bazë të dispozitave të cilat zbatohen për përfaqësim në procedurën kontestimore.⁸² Pas aktvendimit të plotfuqishëm me të cilin procedura ka përfunduar, përkatësisht me rastin e kundërshtimit të deklaruar, si edhe në rastet tjera të cilat sipas dispozitave të këtij ligji ia kthen shkresat gjyqit, noteri do t'ia kthejë shkresat gjyqit kompetent, ndërsa në shkresat e noterit do të mbajë kopjet e shkresave.⁸³

⁸¹ Neni 132, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁸² Neni 133, po aty.

⁸³ Neni 134, po aty

Kundër aktvendimit të noterit i cili vepron si përfaqësues i gjykatës, lejohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit pjesëmarrësve. Kundërshtimi i dorëzohet noterit i cili është i detyruar që pa prolongim, por më së voni në afat prej 3 ditësh, së bashku me shënimet t'ia dorëzojë gjyqit kompetent themelor i cili ia ka besuar veprimin sipas lëndës trashëgimore, për kundërshtimin vendos gjykatësi individual.⁸⁴

Gjyqi, veprimin sipas lëndëve trashëgimore do t'ia besojë noterëve në bazë të rajoneve zyrtare të noterëve të përcaktuara me Ligjin për noteriat.

Kur në rajonin e gjyqit ka më tepër noterë, lëndët do t'u ndahen në mënyrë të barabartë sipas rënditjes alfabetike të mbiemrave të noterëve.⁸⁵

Ftesat dhe dokumentet tjera të cilat i përpilon noteri si përfaqësues i gjykatës, noteri ia dorëzon pjesëmarrësit në pajtim me dispozitat për dorëzim nga Ligji për procedurë kontestimore. Gjyqi, kur ajo është e njëtrajtshme, vetë mund të përpilojë aktvdekje edhe jashtë rastit të lartëpërmendur, nëse me ekstraktin e librit amë së të vdekurve ose me dokumente të tjera publike është vërtetuar vdekja e ndonjë personi ose shpallja e tij i vdekur.

Noteri përveç për shkaqe ekskluzivisht të arsyeshme nuk mund të mos e pranojë punën që i besohet, dhe për këtë vendos gjyqi që ia ka besuar punën. Mbikëqyrjen mbi punën e noterit si përfaqësues i gjykatës, e bën gjyqi që ia ka besuar punën.

Nëse noteri nuk e pranon punën që i është besuar ose nëse gjyqi ia merr punën e besuar, gjykata do t'i urdhërojë noterit t'i dorëzojë shkresat. Gjyqi me gjobë mund ta dënojë noterin i cili do të refuzojë që ta zbatojë urdhëresën e gjykatës ose do të refuzojë t'i dorëzojë shkresat nga puna e besuar. Në raport me gjobën zbatohen dispozitat nga Ligji për përmbarim.kundër aktvendimit për dënim lejohet ankesë në gjyqin e shkallës së dytë, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktvendimit.Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk lejohen mjete të jashtëzakonshme juridike.⁸⁶

Në rast të ndërprerjes së punës së noterit ose ndryshimit të selisë zyrtare të noterit të cilit gjyqi ia ka besuar zbatimin e procedurës trashëgimore, do të veprohet në bazë të dispozitave të Ligjit për noteriat, që kanë të bëjnë me procedurën me shkresat noteriale pas zbrazjes së vendit të noterit.

⁸⁴ Neni 127, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁸⁵ Neni 135, po aty

⁸⁶ Neni 138, po aty

Shpërblimi dhe shpenzimet e noterit si përfaqësues i gjykatës në zbatimin e procedurës trashëgimore përcaktohet ashtu që një shpërblim ka të bëjë me të gjitha veprimet e ndërmarra në një procedurë trashëgimore. Me Rregulloren për tarifën noteriale do të përcaktohet shpërblimi i noterit për zbatimin e procedurës trashëgimore. Me këtë rregullore do të përcaktohen se për cilat veprime noteri ka të drejtë në shpërblim të posaçëm (regjistrim të trashëgimisë dhe ngjashëm). Kur në procedurën trashëgimore noteri vepron si i besuar i gjykatës, nuk paguhet taksë noteriale.⁸⁷

3.2.1 Ndërprerja e procedurës së shqyrtimit të pasurisë trashëgimore

Ky veprim i noterit ka për qëllim të ndal procedurën dhe do t'i udhëzoj pjesmarësit në procedurë kontestimore apo administrative atëherë kur ndërmjet subjekteve procedurale paraqitet çfarëdo lloj kontesti për të drejtat të tyre të cilët të drejta dalin nga shqyrtimi i masës trashëgimore të trashëgimlënësit.⁸⁸ Si fakte të tilla konsiderohen fakte të cilët kanë të bëjnë me të drejtën trashëgimore respektivisht ato fakte nga të cilat varet e drejta në trashëgimi, fakte të cilët prekin plotfuqishmërinë e testamentit apo përmbajtjen e tij, pra, validitetin e testamentit, fakte të cilët i vejnë në ndonjë dyshim mardhëniet e trashëgimtarëve me trashëgimlënësin, por vetëm kur si bazë për thirje në trashëgimi paraqitet ligji, faktet të cilët paraqiten me rastin e paraqitjes të kërkesës për ndarje nga masa trashëgimore e trashëgimlënësit, sendet të cilët i kanë për përdorim të përditshëm në punët shtëpiake, e cila kërkesë paraqitet nga personat respektivisht nga bashkëshorti/ja e trashëgimlënësit të cilët me të kanë jetuar në bashkësi, fakte të cilët kanë të bëjnë me madhësinë e pjesës trashëgimore përkatësisht me vlerën e saj, fakte të cilët kanë për qëllim të tregojnë padenjësinë e trashëgimtarit për të qenë trashëgimtar me rastin e ndarjes së trashëgimisë dhe fakte të cilët tregojnë heqjen dorë të një apo më shumë trashëgimtarëve nga trashëgimia. Përveç rasteve të cilat i kam përmendur më lartë, Ligji për procedurë jokontestimore parasheh edhe dy raste kur noteri e ndërpret procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë dhe i udhëzon palët të nisin procedurë kontestimore respektivisht administrative edhe pse nuk egziston asnjë kontest

⁸⁷ Nenet 139-140, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁸⁸ Al.1 neni 173, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

lidhur me të drejtat apo faktet. Këto raste janë: kur ndërmjet trashëgimtarëve egziston kontesti për atë se prona e caktuar a duhet të bëj pjesë në trashëgimin e trashëgimlënësit dhe kur ndërmjet trashëgimtarëve paraqitet kontesti lidhur me kërkesat e personave të cilët persona kanë jetuar në bashkësi me trashëgimlënësin, të cilat kërkesa kanë të bëjnë me dhënien e një pjese të trashëgimisë së trashëgimlënësit e cila pjesë i përgjigjet kontributit të tyre në rritjen e vlerës së pronës të trashëgimlënësit.

3.2.2 Aktvendimi për shpalljen e trashëgimtarëve

Pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e pasurisë trasgëgimore, në atë rast me marjen e deklaratave të trashëgimtarëve si dhe " në bazë të rezultateve të procedurës të shqyrtimit të pasurisë trashëgimore"⁸⁹ noteri është i obliguar që me anë të aktvendimit të përfundoj procedurën e tillë, resp. të vendos për pasurinë trashëgimore. Me anë të këtij aktvendimi, noteri përfundimisht i konstaton dhe i cakton trashëgimtarët e trashëgimlënësit të cilët kanë të drejtë të trashëgojnë pasurinë e tij. Me Ligjin për procedurë jokontestimore janë përcaktuar saktësisht të dhënat (përmbajtja) e aktvendimit për trashëgimi.⁹⁰ Në fillim aktvendimi përmban të dhënat për trashëgimlënësin siç janë: emri dhe mbiemri, emri i babait (për gratë e martuara mbiemri i vajzërisë), profesioni, data dhe vendi i lindjes, shtetësia dhe numri amzë. Në vazhdim aktvendimi për trashëgimtarët përmban edhe të dhënat të cilët janë të nevojshme për përcaktimin e madhësisë së pasurisë trashëgimore, të dhënat për trashëgimtarët të cilët me plotfuqishmërinë e këtij vendimi do të jenë titullar të të drejtave dhe obligimeve të cilët më parë kanë qenë të trashëgimlënësit, të dhënat e identifikimit të trashëgimtarëve siç janë: emri, mbiemri, emri i babait (mbiemri i vajzërisë kur kemi të bëjmë me gjininë femërore), vendi i banimit dhe numri amzë i tyre. Në këtë pjesë të aktvendimit do të shënohen edhe të gjitha të dhënat të cilët kanë të bëjnë me madhësinë (vlerën) e pjesës trashëgimore, mënyra e të trashëguarit (ligj - testament) si dhe mardhënia trashëgimtar - trashëgimlënës (bashkëshort/e, prind, fëmijë, të adoptuar, adoptues, etj).⁹¹

⁸⁹ Hamdi, Podvorica, E drejta trashëgimore, Prishtine, 2006, fq. 171

⁹⁰ Neni 177 Ligji për procedurë jokontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁹¹ Fjolla Kaprolli „ Roli i noterit si i besuar i gjykatës në procedurë për shqyrtimin e masës trashëgimore në Republikën e Maqedonisë”, Knowledge- International Journal 2017

3.3 Procedura me testament

Testamenti që e ka lënë i vdekuri i dorëzohet gjykatës për shpallje. Gjyqit të cilit i është dorëzuar ose te i cili ruhet testamenti, kur do të vërtetohet përpiluesi i tij se është i vdekur ose i shpallur si i vdekur, është i detyruar ta hapë testamentin, pa mos e prishur vulën, ta lexojë dhe për këtë të përpilojë procesverbal. Me këtë testamenti është i shpallur. Hapja dhe leximi i testamentit kryhet në prani të dy qytetarëve të moshës madhore, të cilët mund të jenë edhe nga radhët e pasardhësve.⁹²

Gjatë shpalljes së testamentit mund të marrin pjesë pasardhësit, trashëgimtarët dhe personat e tjerë të interesuar dhe të kërkojnë kopje nga testamenti, përkatësisht nga procesverbali për shpalljen e testamentit. Gjyqi, te i cili testamenti ndodhet ose të cilit i është dorëzuar, do ta shpallë testamentin edhe përkundër asaj që për shqyrtimin e trashëgimisë është kompetente gjykata tjetër ose organ i huaj.⁹³

Për shpalljen e testamentit përpilohet procesverbal, i cili përmban:

- sa testamente janë gjetur, ku janë gjendur dhe cilat data mbajnë;
- kush ia ka dorëzuar testamentin gjykatës ose përpiluesit të aktvdekjes;
- dëshmitarët që kanë marrë pjesë në shpalljen e testamentit;
- testamenti a është dorëzuar i mbyllur ose i hapur dhe me çfarë vule ka qenë i vulosur, dhe
- përmbajtjen e testamentit.

Nëse gjatë hapjes së testamentit vërehet se vula është prishur ose në testament diçka është shlyer, hequr vijë ose përmirësuar ose nëse gjendet diçka tjetër e dyshimtë, e gjitha evidentohet në procesverbal. Në testamentin e shpallur gjyqi do të vë vërtetim se është i shpallur, do ta vë edhe datën e shpalljes, dhe do të shënojë edhe numrin dhe datën e testamenteve tjera që janë gjendur ose shpallur.⁹⁴

Nëse i vdekuri ka bërë testament me gojë, e për këtë ekziston dokument të cilin dëshmitarët e kanë nënshkruar, përmbajtjen e këtij dokumenti gjyqi do ta shpallë në mënyrën e përcaktuar

⁹² Neni 156, Ligji për procedurë jokontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁹³ Neni 156, Ligji për procedurë jokontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁹⁴ Neni 157, po aty

për shpalljen e testamentit të shkruar. Nëse nuk ka dokument të atillë, dëshmitarët para të cilëve është deklaruar testamenti me gojë do të dëgjohen çdonjëri veças për përmbajtjen e testamentit, e veçanërisht për rrethanat nga të cilat varet plotfuqishmëria e tij, andaj procesverbali për marrjen në pyetje të dëshmitarëve do të shpallet në bazë të dispozitave që vlejnë për shpalljen e testamentit të shkruar.

Nëse pjesëmarrësi kërkon që dëshmitarët e testamentin me gojë të dëgjohen nën betim ose nëse gjyqi vlerëson se marrja e këtillë në pyetje është e nevojshme, do të caktoj seancë për marrjen në pyetje të këtyre dëshmitarëve. Në seancë thirren edhe propozuesit, ndërsa personat tjerë të interesuar vetëm me atë nëse nuk prolongohet procedura.⁹⁵

Kur shpalljen e testamentit me shkrim ose me gojë e kryen gjykata e cila nuk është gjykatë për trashëgimi, ajo gjykatë procesverbalin për shpalljen e testamentit, së bashku me testamentin e shkruar burimor, përkatësisht me dokumentin për testament me gojë, do t'ia dorëzojë gjykatës për trashëgimi, ndërsa për vete do të mbajë kopjet e tyre.⁹⁶

3.4 Statistika për numrin e lëndëve të pranuar nga Noterët për çështjet trashëgimore në RMV

Table 1: Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2017

Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2017	18,124
Lëndët për të cilat nuk është filluar procedura (nuk është ndërmarrë asnjë veprim)	2,032
Lëndët që janë në proces e sipër (janë ndërmarrë veprime)	5,064
Lëndët e zgjidhura në mënyrë të plotfuqishme	9,578
Lëndët plotfuqishmërisht të zgjidhura të kthyer në gjykatë	8,783
Ankesa të paraqitura	32
Lëndët për të cilat është marrë vendimi se nuk zhvillohet asnjë procedurë për mungesë të pronës	2,155

97

⁹⁵ Neni 158, Ligji për procedurë jokontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁹⁶ Neni 159, Ligji për procedurë jokontestimore, gazeta zyrtare nr.09/2008

⁹⁷ Të dhëna të marra më 10.12.2020 nga Oda e noterëve të RMV-së nëpërmjet emailit zyrtar të Odës.

Gjatë vitit 2017 numri total i lëndëve të vlerësuara nga gjykata ka qenë 18,124, ndër to për të cilat nuk është filluar procedura janë 2,032 raste. Sa i përket lëndët që kanë mbetur në procedurë e sipër janë 5,064 lëndë, kurse të zgjidhura dhe të përfunduara në mënyrë të plotfuqishme janë 9,578 raste. Lëndë të kthyer prap në gjykatë edhe pse janë të zgjidhura janë 8,783 raste. Në total rastet e vitit 2017 vetëm 32 prej tyre kanë parashtruar ankesë dhe 2,155 raste të cilat kanë përfunduar si të pa zgjidhura si pasojë e mungesës së pronës.

Table 2: Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2018

Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2018	17,379
Lëndët për të cilat nuk është filluar procedura(nuk është ndërmarrë asnjë veprim)	1,680
Lëndët që janë në proces e sipër (janë ndërmarrë veprime)	4,874
Lëndët e zgjidhura në mënyrë të plotfuqishme	9,935
Lëndët plotfuqishmërisht të zgjidhura të kthyer në gjykatë	9,049
Ankesa të paraqitura	34
Lëndët për të cilat është marrë vendimi se nuk zhvillohet asnjë procedurë për mungesë të pronës	1,431

98

Gjatë vitit 2018 numri total i lëndëve të vlerësuara nga gjykata ka qenë 17,379, ndër to për të cilat nuk është filluar procedura janë 1,680. Sa i përket lëndët që kanë mbetur në procedurë e sipër janë 4,874 lëndë, kurse të zgjidhura dhe të përfunduara në mënyrë të plotfuqishme janë 9,935 raste. Lëndë të kthyer prap në gjykatë edhe pse janë të zgjidhura janë 9,049 raste. Nga të gjitha lëndët e besuara tek noterët për vitit 2018 vetëm për 34 prej tyre janë parashtruar ankesë dhe 1,431 raste të cilat kanë përfunduar si të pa zgjidhura si pasojë e mungesës së pronës. Në krahasim me vitin e kaluar(2017) në vitin 2018 ka ulje të rasteve në përgjithësi të besuara nga gjykata e deri tek numrat për lëndët për të cilat nuk është ndërmarrë asnjë veprim për shkak të mungesës së pronës.

⁹⁸ Të dhëna të marra më 10.12.2020 nga Oda e noterëve të RMV-së nëpërmjet emailit zyrtar të Odës.

Table 3: Lëndët e besuara nga gjykatëa gjatë vitit 2019

Lëndët e besuara nga gjykata gjatë vitit 2018	17,671
Lëndët për të cilat nuk është filluar procedura(nuk është ndërmarrë asnjë veprim)	1,485
Lëndët që janë në proces e sipër (janë ndërmarrë veprime)	4,910
Lëndët e zgjidhura në mënyrë të plotfuqishme	10,612
Lëndët plotfuqishmërisht të zgjidhura të kthyer në gjykatë	9,306
Ankesa të paraqitura	32
Lëndët për të cilat është marrë vendimi se nuk zhvillohet asnjë procedurë për mungesë të pronës	1,621

99

Gjatë vitit 2019 numri total i lëndëve të vlerësuara nga gjykata ka qenë 17,671, ndër to për të cilat nuk është filluar procedura janë 1,485. Sa i përket lëndët që kanë mbetur në procedurë e sipër janë 4,910 lëndë, kurse të zgjidhura dhe të përfunduara në mënyrë të plotfuqishme janë 10,612 raste. Lëndë të kthyer prap në gjykatë edhe pse janë të zgjidhura janë 9,306 raste. Nga të gjitha lëndët e besuara tek noterët për vitit 2019 vetëm për 32 prej tyre janë parashtruar ankesë dhe 1,621 raste të cilat kanë përfunduar si të pa zgjidhura si pasojë e mungesës së pronës. Sa i përket vitit 2019 gjithashtu është në ulje e sipër në krahasim me vitin 2017, por në ngritje nga viti 2018.

⁹⁹ Të dhëna të marra më 10.12.2020 nga Oda e noterëve të RMV-së nëpërmjet emailit zyrtar të Odës.

4 NOTERI NË TË DREJTËN E KRAHASUAR

4.1 Noteria dhe e drejta trashëgimore në Shqipëri

Në Shqipëri pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912 e deri në vitin 1929, noteria rregullohej në bazë të ligjit otoman „Mbi noterët“ (Mukavelat muhariri nizajm nesi) i cili sipas vendimit të qeverisë së Vlorës të vitit 1912 do të rregullonte organizimin noterial gjersa do të dilte ligji i ri . Nga viti 1929 e deri në vitin 1946 , noteria rregullohej me ligjin mbi organizimin noterial dhe me tarifen e aneksuar , i cili hyri në fuqi më 1 prill 1929. Sipas këtij ligji noterët nuk ishin nëpunës shteti por profesionist, që ushtronin funksione publike , ata emëroheshin nga gjykatat e shkallës së parë dhe mund të ushtronin funksionet e tyre, pasi paraqitnin një garancë për sigurimin e derdhjes në arkën e shtetit të taksave shtetërore që arkëtonin dhe për sigurimin e veprimeve noteriale . Në ushtrimin e funksioneve të tyre, noterët ishin në mbikqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë. Pas vitit 1944 , doli ligji Nr.357 , datë 22.11.1946 "Mbi ushtrimin e funksioneve noteriale" të cilat iu ngarkuan gjyqtarëve popullorë dhe deri sa hyri në fuqi dekreti 2812 , datë 22.12.1958 "Mbi noterine" dispozitat e ligjit "Mbi organizimin noterial" të vitit 1929 zbatoheshin në fushën e veprimeve noteriale si rregulla juridike ndihmëse në bazë të ligjit 61 , datë 17.05.1945 mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promologuara gjatë okupacionit të huaj mbi pavlefshmërinë e vendimeve penale të dhëna gjatë asaj kohe prej autoriteteve ushtarake dhe mbi vleften e dispozitave ligjore që ishin në fuqi para datës 7 prill 1939. Më vonë del dekreti Nr. 4838, datë 11.05.1971 "Mbi noterinë", në bazë të të cilit kishte dalë dhe rregullorja përkatëse e Gjykatës së Lartë , date 14.01.1972 , dhe më pas kësaj , ky dekret u shfuqizua me Kodin e Procedurës Civile miratuar me ligjin 6341, datë 27.06.1981 , në të cilin parashikoheshin dispozitat për noterinë në kreun XVII nga nenet 220 deri 225 . Lidhur me zbatimin e dispozitave procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile i vitit 1982, Gjykata e Lartë ka nxjerrë Udhëzimin " Mbi noterinë ", me Nr. 720 Prot., datë 10.07.1985 , në të cilin parashikohen në përgjithësi mënyra e veprimtarisë së noterëve.¹⁰⁰

Pas përmbyesjes së sistemit monist dhe ardhjes së demokracisë në qershor të vitit 1994 , me ligjin nr.7829 kemi për herë të parë një rregullim ligjor të plotë dhe deri diku bashkëkohor për shërbimin noterial . Ky ligj ka rreth 70 nene dhe e përcakton noterinë si profesion të lirë.

¹⁰⁰ Av. Petraç çuri, “ E drejta Procedurale Civile & Noteria”, 2008, fq.372

Me këtë ligji, ata që u bënë noterët e parë të njohur si të tillë kanë qenë ish - këshilltarë të zyrave juridike, që për hir të së vërtetës duke qenë të pa mësuar me rregullat e tregut të lirë, shpesh herë dhe të paafte profesionalisht dhe të joshur nga mënyra e lehtë e pasurimit me këtë profesion, e vunë në pikpyetje seriozisht rolin e noterit si dëshmitar i të vërtetës.

Avokati i famshëm italian F.Carnelutti e shpreh thjesht rolin e noterit edhe në Shqipëri duke theksuar se : Sa më shumë ti drejtohem noterit, aq më pak do ti drejtohem gjykatësit. Kjo është në esencë ajo çka ka për detyrë noteri edhe në Shqipëri, por që për arsyt që theksuam më lartë bën shpesh herë rolin e kundërt dhe palët duhet ti drejtohen gjykatës për të "rregulluar" gabimet e Noterëve. Teoritikisht noteri shqipëtar i përket atij latin, për dallim nga *notary public* i tipit anglosakson që është prezent në Britani të Madhe, Amerikë e vende të tjera.¹⁰¹

Noteria në Republikën e Shqipërisë kryen veprimtari juridike në shërbim të personave fizikë e juridik, nëpërmjet kryerjes së veprimtarive noteriale, në pajtim me kushtetutën e legjislacionit në fuqi. Noteri, në ushtrinin e profesionit të tij, është i lirë dhe i nënshtrohet vetëm ligjit. Veprimtaria, kompetencat, detyrat, përgjegjësit si dhe kualifikimet sa i përket këtij institucioni të pavarur publik rregullohen me ligjin aktual të Republikës së Shqipërisë, ngjajshëm sikurse edhe te ne e gjithë kjo veprimtari kontrollohet nga ministria e drejtësisë.

Noteri ka këto të drejta :

- Të hartojë teste, projekte për veprime të tjera juridike e dokumente, të japë kopje dokumentesh dhe shkurtime prej tyre, si dhe të kryejë veprime të tjera noteriale, të parashikuara me ligji.
- Të japë sqarime për probleme që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve noteriale ;
- Të kërkojë nga personat fizikë e juridikë të dhëna e dokumente që janë të domosdoshme për kryerjen e akteve dhe të veprimeve noteriale.¹⁰²

Pra, gama e të drejtave është e gjerë, por ajo ka si qëllim kryesor të saj kryerjen nga noteri të akteve e veprimeve noteriale, duke kërkuar rregullisht nga personat juridike e fizikë private e shtetërore ato dokumente që ndihmojnë shtetasit në zgjidhjen e problemeve të tyre, ku roli i

¹⁰¹ [http://Ministria e drejtësisë, SHËRBIMI NOTERIAL, Lindita Blinishti](http://Ministria_e_drejtësisë,_SHËRBIMI_NOTERIAL,_Lindita_Blinishti)

¹⁰² Neni 22, Ligji i Noterisë së Republikës së Shqipërisë, Nr.7829, datë 1.6.1994

noterit është i domosdoshëm. Këto organe janë të detyruar që t'i përgjigjen noterit në kërkesat e tij, brenda afateve ligjore të përcaktuata me ligj.¹⁰³

Noteri ka për detyrë:

- Të kryejë për personat fizikë e juridikë ato veprime që synojnë realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme, t'i sqarojë ata për të drejtat dhe detyrat që rrjedhin prej tyre , si dhe të paralajmërojë për pasojat që vijnë nga kryerja e veprimeve noteriale , me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre nga mosdijenja e ligjit .
- Të kryejë detyrat e tij me paanësi , në bazë të ligjit dhe të betimit të bërë si noter ,
- Të ruajë të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij dhe që përbëjnë sekret profesional .
- Të mos lejojë njohjen me përmbajtjen e testamenteve , lëshimin e kopjeve a shkurtimeve të tyre para vdekjes së trashëgimlënësit testamentar , përveç rasteve kur e kërkon vetë ai ose përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme .
- Të refuzojë kryerjen e veprimeve noteriale në rastet që nuk lejohen nga legjislacioni, nga konventa ndërkombëtare , të pranuar përgjithësisht ose në të cilat ka aderuar vendi ynë .
- Të këshillojë palët që të paraqiten në organet e tatimit për efekt të pagimit të tatimit , në rastet kur kryen veprimet noteriale që kanë të bëjnë me tjetërsimin e pronësisë .
- Të përmirësojë vazhdimisht kualifikimin e tij .
- Të derdhë kuotën që caktohet çdo vit nga Këshilli Kombëtar i Notereve .
- Të mos lejojë njohjen me përmbajtjen e testamenteve, lëshimin e kopjeve a shkurtimeve të tyre para vdekjes së trashëgimlënësit testamentar , përveç rasteve kur e kërkon vete ai ose përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme .
- Të mbajë hapur zyrën noteriale sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim . Kur për shkaqe të përlegjura noteri mungon për më shumë se 3 ditë , emëron një zëvendës të tij nga noterët e dhomës, gjithnjë duke marrë pëlqimin e kryetarit të këshillit të dhomës së noterëve .¹⁰⁴

Të dhëna për përmbajtjen e akteve noteriale të kryera mund t'u jepen vetëm personave , në emër të cilëve janë kryer këto veprime .

¹⁰³ “E drejta procedural civile & Noteria” Petraq Çuri, 2008, fq.388

¹⁰⁴ Neni 23, Ligji për Noterinë në Republikën e Shqipërisë, Nr.7829, datë 1.6.1994

Gjykata , prokuroria dhe hetuesia mund të njihen me të dhena të kësaj natyre , kur kanë filluar ndjekjet penale kundër noterit lidhur me detyrën e tij , ose kundër shtetasit që është subjekt në veprime noteriale të kryera , por gjithnjë pa u dëmtuar interesat themelore të shtetit a shtetasve të veçantë.

Pra, detyrat e noterit përcaktojnë një mënyrë sjelljeje të noterit në raport :

- me ligjin ;
- me shtetasin

Sa i përket çështjes së trashëgimisë, kur noteri vihet në dijeni zyrtarisht nga personat e interesuar për vdekjen e personit që ka bërë testamentin, mban një procesverbal, në të cilin përmendet akti i vdekjes dhe bën kalimin e testamentit në regjistrin e përgjithshëm të akteve noteriale.¹⁰⁵ Njëkohësisht ai njofton me shkrim personat për të cilët disponon testament.

Testamenti bëhet në dy forma: ollograf dhe me akt noterial. Testamenti me akt noterial redaktohet nga noteri dhe nënshkruhet nga trashëgimlënësi në prani të noterit. Kur trashëgimlënësi nuk di, ose për shkak sëmundjeje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruaj, testament nënshkruhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin “për noterinë”.¹⁰⁶ Pra, në Republikën e Shqipërisë ka regjistra të posaçëm ku mbahet evidencë për ekzistimin apo përpilimin e çdo testamenti nga ana e testatorit dhe me ndryshimet e fundit të bëra në ligj të gjithë testamentet e nënshkruara pranë noterëve, duhet të regjistrohen në Regjistrin kombëtar të testamenteve, ndryshe nga Republika e Maqedonisë së Veriut ku një sistem i tillë ende nuk ekziston.

Trashëgimtari nëse deklaron rregullisht që heq dorë ose jo nga trashëgimia, nuk mund ta shfuqizojë më pas këtë deklaram.¹⁰⁷ Kur trashëgimtari vdes para se të kalojë afati për heqje dorë nga trashëgimia, e drejta për heqje dorë u kalon trashëgimtarëve të tij.¹⁰⁸

¹⁰⁵ Si hartohet një testament : <https://pdfslide.tips/documents/si-hartohet-nje-testament.html>

¹⁰⁶ Neni 397, Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.7850, 1994

¹⁰⁷ Neni 339, po aty

¹⁰⁸ Neni 340, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994

Heqja dorë nga trashëgimia mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj.¹⁰⁹

Që nga viti 2013, proçesi i lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë nuk realizohet më nga gjykatat, por nga noteri, të cilit i është besuar ky proçes, me qëllim lehtësimin e proçedurave, rritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarët dhe lehtësimin e punës së gjykatave. Noteri ndër vite, si institucion besueshmërie, shpesh është zëvendësuar nga gjyqtari në veprimtarinë e tij, por edhe ka bërë veprimtari që janë kryer nga gjykatat.

¹⁰⁹ Neni 335, Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.7850, 1994

4.2 Noteria dhe e drejta trashëgimore në Kosovë

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, fatkeqësisht, Kosova mbeti jashtë kufijve të shtetit amë, në kuadër të kreatorës shtetërore të quajtur ish-Jugosllavi. Prej Luftës së Dytë Botërore e deri në përfundim të Luftës çlirimtare të Kosovës më 1999, zhvillimin e së drejtës trashëgimore në Kosovë e karakterizojnë 4 faza më kryesore. E para, përfshin periudhën kohore prej vitit 1945 deri më 1955. Këtë periudhë e karakterizojnë zbrastësi të shumta të normave juridike nga lëmi i së drejtës trashëgimore. Ish-Jugosllavia abrogoi me dekret të gjitha ligjet e nxjerra para 6 prillit 1941 dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, përveç atyre që nuk ishin në kundërshtim me rendin juridik socialist. Në një situatë të tillë, vetë gjykatat vlerësonin se cilat dispozita ligjore ishin në kundërshtim e cilat jo me këtë rend juridik dhe kjo shërbeu si bazë për marrjen e vendimeve të ndryshme mbi të njëjtën çështje dhe për për diskriminim drastik të shqiptarëve.¹¹⁰

Faza e dytë fillon nga viti 1955, kur hyri në fuqi Ligji për trashëgimi i ish-Jugosllavisë e që u zbatua edhe në Kosovë. Sado që ky ligj përmban parimet e së drejtës trashëgimore të njohura edhe me norma juridike të së drejtës ndërkombëtare, si parimin e barazisë të të gjithë personave fizikë në trashëgimi, që e drejta e trashëgimisë fitohet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, si trashëgimtarë ligjorë mund të paraqiten personat deri në radhën e pestë të trashëgimisë. Shqiptarët vazhdojnë të jenë objekt diskriminimi në mënyra dhe forma të ndryshme.¹¹¹

Faza e tretë fillon me amandamentet kushtetuese në Kushtetutën e ish-Jugosllavisë të vitit 1963, të cilat u miratuan në vitin 1971. Sipas tyre edhe Kosova merr kompetencat për nxjerrjen e Ligjit për rregullimin e marrëdhënieve trashëgimore. Në kuadër të kompetencave të fituara më 30 dhjetor 1974, Kosova nxjerr ligjin e vet të parë për trashëgiminë. Ky ligj më pas ndryshoi dy herë, më 1978 dhe pastaj më 1979. Rëndësia e tij ishte e madhe, sepse për herë të parë Kosova rregullon të drejtat trashëgimore në territorin e vet, duke mos i përfshirë këtu bazat e marrëdhënieve juridike trashëgimore, të cilat edhe në vazhdimësi Republika e Serbisë i mbante ne kompetencë të vet.¹¹²

¹¹⁰ Hamdi Podvorica, "E drejta trashëgimore", Prishtinë 2006, fq.10

¹¹¹ Po aty, fq.11

¹¹² Po aty, fq.12

Pa dyshim faza e katërt është më e rëndësishmja në zhvillimin e së drejtës trashëgimore në Kosovë. Më 28 korrik 2004 Kuvendi miratoi Ligjin e parë për trashëgiminë në Kosovën e çliruar nga okupatori serb. Ky ligj hyri në fuqi pas firmosjes nga përfaqësuesi Special i Sekretarit të OKB-së për Kosovën, rregullon bazat e marrëdhënieve juridike trashëgimore në harmoni me standardet e së drejtës ndërkombëtare, duke u garantuar të gjithë personave fizikë të drejtën e trashëgimisë. Të gjithë personat fizikë në kushte të njejta do të jenë të barabartë në trashëgimi, pa dallim race, kombi apo gjinie.¹¹³

Trashëgimia fitohet me ligj ose me testament. Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk lë testament ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur është testamenti tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adaptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre. Me ligj trashëgimlënësin e trashëgon edhe bashkëshorti jashtëmartesor, i cili barazohet me bashkëshortin martesor¹¹⁴, nëse çifti ka jetuar për një kohë të gjatë së bashku të paktën 5 vite, nëse nga kjo marrëdhënie kanë lindur fëmijë të paktën 3 vite.¹¹⁵

Edhe pse në Kosovë noteria është funksionalizuar në vitin 2012, këto shërbime kanë funksionuar prej kohësh si një përbërës integral i sistemeve të ndryshme juridike civile. Duke qenë se noterët janë shërbyes publik, ata kanë një karakter kuazi gjyqësor, ku vula e tyre është e barabartë me vendimin e gjykatës, të paktën në çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë e pasurisë, procedurat e trashëgimisë dhe kontratat.¹¹⁶ Kështu, noterët kanë qenë historikisht figura kyçe në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike, siç janë krijimi i biznesit, huadhënia dhe mbrojtja e kontratës, si dhe verifikimi i transaksioneve të pronave dhe procedurave të trashëgimisë.

Profesioni i noterit është një nga profesionet e reja të lira juridike të futura në Kosovë vitet e fundit, pjesërisht për të lehtësuar barrën e madhe për gjykatat. Zhvillimi i Ligjit të parë për Noterinë u mbështet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e cila ofroi mbështetje edhe për zbatimin e Ligjit dhe trajnimin e kandidatëve për noterë, etj. Në shtator

¹¹³ Hamdi Podvorica, “E drejta trashëgimore“, Prishtinë 2006, fq.12

¹¹⁴ Neni 11, Ligji për trashëgiminë i Kosovës, gazeta zyrtare nr. 26/2004

¹¹⁵ Neni 28, po aty.

¹¹⁶ Joanna Brooks “Vlerësimi i rrezikut për Odën e noterëve të Kosovës”, Swiss Cooperation Office Kosovo, 2019

2011, MD-ja çertifikoi 48 noterët e parë, në mesin e të cilëve ishin 3 jo shqiptarë dhe 10 gra.¹¹⁷ Raundi i parë i 39 noterëve në të gjithë territorin e Kosovës filloi punën në maj 2012, fillimisht nën një sistem të dyfishtë përmes të cilit palët mund t'i drejtoheshin noterit ose gjykatës. Që nga viti 2013, të gjitha lëndët jo-kontestimore me të cilat merreshin gjykatat, kaluan nën juridiksionin e noterëve.¹¹⁸

Në përgjithësi, ligjet dhe legjislacioni dytësor që e rregullojnë Odën e Noterisë së Kosovës janë mjaftë të përshtatshme. Megjithatë, në rregullore dhe në ligje si dhe në zbatimin e tyre, ekzistojnë mangësi, që pengojnë fuqinë vepruese të tyre. Rekomandohet rishikimi i ligjit aktual nga Ministria e Drejtësisë dhe Odës së Noterëve që të ndryshohet procedurat e pranimit, procedurat disiplinore dhe sanksionet.

Pas vdekjes së personit duhet të inicohet procedura e shqyrtimit të pasurisë ku në bazë të saj zhvillohet edhe procedura për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve pasurore nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët e tij. Duke u bazuar në ligjin për procedurën jokontestimore duhet procesuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata në momentin që sigurohet informacioni për vdekjen e personit. Në vitin 2018 me plotesimet e LPJK-së (Ligji i procedurës jokontestimore të Kosovës) është zgjeruar autorizimi që edhe palët e interesuara si dhe noterët të mund të inicojnë procedurat pas informimit nga organi administrativ kompetent. Palët e interesuar janë ata persona që pretendojnë për të drejtën e trashëgimisë, ndërsa noterët e procesojnë këtë procedurë në bashkëpunim me Odën e Noterëve dhe Organin Administrativ.

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore inicohet nga pala e interesuar, gjykata apo nga noteri pas informimit të tij nga organi kompetent se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor.¹¹⁹

Me rastin e vdekjes së një personi ose shpalljes si i vdekur me vendim gjyqësorë të formës së prerë nga gjykata, hartohet dëshmia e vdekjes¹²⁰. Dëshmia e vdekjes hartohet nga Zyra e Gjendjes Civile, sipas të dhënave të marra në mënyrë të pavarur nga regjistri civil kurse të dhënat për hartimin e dëshmisë së vdekjes mund të verifikohen edhe nga të afërmit e personit të vdekur,

¹¹⁷ Joanna Brooks “Vlerësimi i rrezikut për Odën e noterëve të Kosovës”, Swiss Cooperation Office Kosovo, 2019

¹¹⁸ Joanna Brooks “Vlerësimi i rrezikut për Odën e noterëve të Kosovës”, Swiss Cooperation Office Kosovo, 2019, faqe 13

¹¹⁹ Neni 127, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

¹²⁰ Emërtimi i fjalës aktvdekje është zëvendësuar me fjalën dëshmi e vdekjes me ndryshimet e bëra në Ligjin për procedurë jokontestimore.

nga personat me të cilin personi i vdekur ka bashkëjetuar, si dhe nga personat e tjerë që mund të japin të dhëna që shënohen në dëshminë e vdekjes.¹²¹

Pas hapjes së procedurës trashëgimore, por para se të bëhet heqja dorë nga trashëgimia ose ndarja e trashëgimisë, noteri është përgjegjës për mbajtjen e seancave informuese në të cilën do t'i ftojë të gjithë trashëgimtarët e mundshëm të marrin pjesë në seancë informuese në të cilën do t'i njoftojë me të drejtat dhe detyrimet e tyre si trashëgimtarë.¹²²

Pasuria e trashëgimlënësit patjetër do të regjistrohet në këto raste: a) kur nuk dihen trashëgimtarët apo vendbanimi i tyre; b) kur trashëgimtarët janë persona që për shkak të moshës së mitur, sëmundjes mendore ose rrethanave të tjera nuk janë fare të aftë, ose nuk janë plotësisht të aftë që të kujdesen vetë për punët e veta, dhe c) kur pasuria trashëgimore duhet t'i dorëzohet komunës apo personit juridik tjetër.¹²³

Pasi të dorëzohet dëshmia e vdekjes tek noteri, ai konstaton nëse është kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Nëse nuk është kompetent Oda e Noterëve të Kosovës e dërgon tek noteri kompetent, kurse nëse noteri është kompetent, ai bën njoftimin me trashëgimtarët si dhe bën publikimin e njoftimit për inicimin e asaj procedure trashëgimore në Portalin Shtetëror të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Para se të fillojë procedura e trashëgimisë, noteri mban një seancë informuese për të gjithë trashëgimtarët/et, jo më largë se tri ditë pune nga përfundimi i afatit 30 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi për t'i njoftuar ata/ato me të drejtat e tyre në trashëgimi.¹²⁴ Çdo trashëgimtarë që nuk merr pjesë në seancën informuese do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në seancë informuese përveç nëse ai trashëgimtarë ka dërguar deklaratë të vërtetuar. Në qoftë se nga të dhënat e aktvdekjes shihet se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasuri, apo se ka lënë vetëm pasuri të luajtshme, e asnjëri nga trashëgimtarët nuk kërkon që të shqyrtohet çështja, atëherë gjykata me aktvendim do të vendos që mos të shqyrtohet pasuria trashëgimore.¹²⁵

Pas përfundimit të seancës informuese, noteri mban seancë kryesore me trashëgimtarët për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Për personin që nuk ka dhënë deklaratën për heqjen dorë nga

¹²¹ Neni 133, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore, Gazeta zyrtare nr.22/18

¹²² Neni 33, po aty

¹²³ M. Musa, K. Musa, „E drejta e procedurës civile II”, Gjilan, 2017, fq. 108.

¹²⁴ Neni 33, Ligji për plotësimi- ndryshimin e nenit 161 të Ligjit për procedurë jokontestimore, gazeta zyrtare nr. 22/18

¹²⁵ Paragrafi 1 neni 157, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

trashëgimi konsiderohet se dëshiron të bëhet trashëgimtar. Personi i cili vleftësisht e ka dhënë deklaratën me të cilën e ka pranuar trashëgimin, nuk ka të drejtë që më vonë ta revokojë atë.¹²⁶

Nëse si trashëgimtar paraqiten personat e mitur dhe personat e tillë dëshirojnë të heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgim, atëherë noteri duhet të merr pëlqimin e organit të kujdestarisë.¹²⁷ Që deklarata për heqje dorë nga trashëgimia të jetë e vlefshme, duhet të plotësohen këto kushte: a) përmbajtja e deklaratës duhet të jetë e kuptueshme; b) përmbajtja duhet të jetë e lejueshme dhe c) të shprehë qartë vullnetin e lire se trashëgimtari heqë dorë nga trashëgimia.¹²⁸

Pas përfundimit të seancës informuese dhe seancës për shqyrtimin kryesorë të pasurisë trashëgimore, noteri vërteton se cilëve nga trashëgimtarët u takon e drejta për të trashëguar dhe me aktvendim i shpallë ata trashëgimtarë.

Në qoftë se në procedurën trashëgimore të gjithë trashëgimtarët dhe legatarët me marrëveshje i propozojnë gjykatës ndarjen dhe mënyrën e ndarjes, gjykata marrëveshjen e këtillë e inkorporon në aktvendimin për trashëgimin. Gjykata vepron kështu edhe kur ndarjen e pasurisë trashëgimore e bënë duke e aprovuar kërkesën e trashëgimtarit që ka jetuar në bashkësi familjare me të vdekurin, që t'i lihen sendet e caktuara që shërbejnë për nevoja të përditshme apo për ushtrimin e profesionit.¹²⁹ Aktvendimi për trashëgimin i dërgohet të gjithë trashëgimtarëve dhe legatarëve, si dhe personave që gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore kanë paraqitur kërkesa për trashëgim.¹³⁰ Po qe se me anë të testamentit trashëgimtarit i është urdhëruar përmbushja apo sigurimi i detyrimit në dobi të personit që nuk ka zotësi të kujdeset për interesat dhe të drejtat e tia, apo për realizimin e ndonjë dobie publike, noteri do t'i caktojë masat e nevojshme të sigurimit.¹³¹ Kur përbërja e pasurisë trashëgimore vetëm pjesërisht është jokontestuese, noteri, pasi të konstatojë kush janë trashëgimtarët, respektivisht legatarët, do të jep aktvendim të pjesëshëm për trashëgimin me të cilin i cakton trashëgimtarët dhe legatarët dhe pjesën e pasurisë së pakontestueshme që hynë në pasurinë trashëgimore.¹³² Në qoftë se pasi të jetë bërë i formës së prerë aktvendimi për trashëgimin gjendet testamenti i trashëgimlënësit, gjykata ose noteri te i cili është dhënë për ruajtje testament do ta shpallë atë, dhe procesverbalin për shpalljen dhe kopjen e

¹²⁶ Neni 164, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

¹²⁷ Neni 130 paragrafi 3, Ligji nr. 06/L-008 për ndryshim-plotësim të Ligjit për Trashëgimi në R. Kosovës.

¹²⁸ H. Podvorica "E drejta trashëgimore", Prishtinë 2010, faqe 85.

¹²⁹ Neni 172, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore

¹³⁰ Neni 173, po aty

¹³¹ Neni 174 paragr. 3, po aty.

¹³² Neni 177, po aty

testamentit do t'ia dërgoj noterit i cili e ka zhvilluar procedurën e trashëgimisë, kurse origjinalin e mbanë për vete.

Legjislacioni që rregullon fushën për trashëgimi të pronës mbetet i njëjtë dhe trajtimi i këtyre lëndëve është me rëndësi ende të madhe sikurse edhe më herët, mirëpo puna dhe qasja e noterive në këtë fushë ka ndikuar sado pak në përshpejtimin e zgjidhjes së këtyre lëndëve. Është aritur në përfundim, që sfidat me të cilat është ballafaquar Gjykata Themelore, rreth zgjidhjes së këtyre lëndëve, pak a shumë me të njëjtat ballafaqohen edhe tani zyrat e noterive. Këto sfida janë mungesa apo dokumentacioni i parregullt kadastral, si dhe funksionimi i një sistemi elektronik i të dhënave me qasje të përbashkët nga institucionet relevante për këto raste, që do të kishte lehtësuar jashtëzakonisht shumë punën dhe do të kishte ndihmuar në ngritjen e bashkëpunimit mes faktorëve të rëndësishëm për këtë veprimtari, e tërë kjo që t'i ofrohet një shërbim efikas dhe i shpejtë qytetarit.¹³³ Pa marrë parasysh sfidat dhe problemet që sistemi noterial i Kosovës ballafaqohet, zyrat e noterive mundohen që qytetarëve të vendit t'iu ofrojnë shërbime cilësore dhe realizim të të drejtave të tyre. Trashëgimia e pronave në Kosovë, që tani ka kaluar si kompetencë e noterive, është duke u përmirësuar si shërbim për qytetarë, dhe me reforma apo përmirësime të mëtutjeshme kjo fushë e së drejtës do të realizohej në nivel edhe më të kënaqshëm.¹³⁴

¹³³ Roli i noterive në trashëgiminë e pronave, marrë nga <https://dspace.aabedu.net/bitstream/handle/123456789/334/11-Shqipe-Shaqiri-Roli-i-noterive-n%C3%AB-trash%C3%ABgimin%C3%AB-e-.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

¹³⁴ Shqipe Shaqiri "Roli i noterive në trashëgiminë e pronave", 2016, faqe 93

5 PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Gjatë punimit është përdorur metoda e intervistës direkte dhe janë shqyrtuar temat e rëndësishme në mënyrë jepet një pasqyrë më e qartë rreth rolit të noterisë në të drejtën trashëgimore në RMV.

5.1 Intervista me noteren Ermira Mehmeti (e realizuar më 09.12.2020)

1. Në procedurë trashëgimore a i thërisni të gjithë palët, apo si veproni ?

Noteri ka obligim ligjor që në trashëgimi t'i ftojë të gjithë palët për të cilët ekzistojnë të dhëna, janë paraqitur dhe ka dëshmi se janë trashëgimtarë.

Gjyqi thëret noterin që të udhëheqë procedurë jokontestimore, do te thotë mendohet që me procedurë jokontestimore trashëgimore duhet të vijnë të gjithë palët në të njejtën kohë, sepse nëse nuk vijnë të gjithë në të njejtën kohë dhe për këtë nuk ka ndonjë arsye si përshembull ndonjërit t'i ketë dalë ndonjë punë e paparashikueshme, atëherë mendohet të ketë kontest, se nuk dojnë të takohen, nuk flasin mes vete, nuk kanë marrëveshje në lidhje me ndarjen e pronës trashëgimore, pra, ndarjen e trashëgimisë e kështu me radhë. Ideja është që te noteri kur mbahet seancë, duhet të marrin pjesë të gjithë, që do të thotëse duhet të ketë vetëm një seancë.

A keni pasur ju kësi raste, se e shoh që më shumë keni raste me patundshmërinë?

Kemi pasur një rast deri tani, ku nëna me motren ishte me një anë dhe vëllau në anën tjetër dhe nuk mundeshin të meren vesh për punën e trashëgimisë. Tash ata janë nëpër gjyqe duke kontestu, duke u paditur mes vete, ne nuk mundëm me zgjedh atë procedurë.

Gjykata vetëm e cakton noterin dhe pastaj lënda shkon tek noteri, dhe noteri e mban séance. Nëse në seancë nuk arrihet të shpallet vendimi, atëherë noteri e kthen lëndën në gjykatë me njoftim se ka kontest dhe vazhdon me padi në gjykatë.

2. Na tregoni për bashkëpunimin mes juve si noterë dhe avokatëve ?

Me ndryshimin e ligjit në vitin 2016, avokatët marrin pjesë në procedurë si të autorizuar dhe përfaqësues të trashëgimtarëve. Pa prezencën e avokatit nuk ka kushte për mbajtje të seancës trashëgimore. Do të thotë ndërlidhja mes neve si noterë dhe me avokatët është që ata paraqiten si autorizues të trashëgimtarëve dhe pa ta nuk mund të shqyrtohet seanca për trashëgimi.

3. Si e shqyrtoni transmisionin dhe përfaqësimin? Si veproni në këto raste?

Në këtë rast duhet të mbahet procedurë trashëgimore edhe për atë person, thëriten fëmijët, ndryshe thënë trashëgimtarët e tij, me të drejtë përfaqësimi.

4. Sa raste ka pasur që femra ka dhënë deklaratë për heqje dorë nga trashëgimia dhe se refuzimin e kanë dhënë personalisht ato apo nëpërmjet avokatit ?

Do kisha thënë se kjo është praktike shumë e shpeshtë, që femra heqë dorë e sidomos tek në shqiptarët dhe këtu përmbahet seanca dhe jepen deklaratat. Noteri i lexon deklaratat, përshembull nëse nuk është prezent këtu trashëgimtarja atëherë avokati në emër të trashëgimtarit deklarohet, nëse është këtu atëherë e konfirmon deklaratën për heqje dorë nga trashëgimia apo për pranim të trashëgimisë. Sa raste nuk di të them me numër, por shumica e rasteve statistikisht tek ne heqin dorë.

5. Si do kishit vepruar nëse do të kishit hasur me reproduksion post human(post mortum)?

Nuk kam pasur këso raste deri tash, mirëpo edhe në atë situatë fëmija thirret në trashëgimi. Atij i takon trashëgimia, dhe nëna si e autorizuar, përfaqësues ligjor i fëmijës shpallet si kujdestar, përkatësisht fëmija shpallet trashëgimtarë, por përmes nanës si kujdestar ligjor.

5.2 Intervista me noterin Naser Ziberi (e realizuar më 10.12.2020)

1. Në procedurë trashëgimore a i thërisni të gjithë palët, apo si veproni ?

Prej vitit 2008 deri 2016 palët pjesëmarrëse vetë janë përfaqësuar në procedurë trashëgimore, do të thotë kanë marrë pjesë në procedure, janë deklaruar se pranojnë apo refuzojnë të shpallen trashëgimtarë dhe noteri ka shpallë vendim. Kurse nga viti 2016-2017 palët detyrimisht duhet të përfaqësohen nga avokatë, që do të thotë palët nuk janë të detyruar që të marrin pjesë në seancë. Pra, vetëm me përfaqësuesit e tyre(avokati) mund të zhvillohet procedura. Kuptohet ata kanë të drejtë të marrin pjesë, por nuk mund pa përfaqësues ligjor(avokat) të zhvillohet seancë trashëgimore para noterit. Ky avokat mund të përfaqësojë një palë apo gjithë palët, ose çdo palë me avokatë në veti. Kur kanë marrë pjesë vetëm trashëgimtarë pa përfaqësuesit detyrimisht është dashur që të jenë prezent në seancë dhe atë të gjithë në të njejtën kohë. Përkrahim ligji për procedurë jashtëkontestimore parasheh që ndonjëri nga pjesëmarrësit të mund të jep deklarata jashtë seancës, në procesverbal tek noteri ai shkon dhe deklarohet para mbajtjes së seancës.

2. Na tregoni për bashkëpunimin mes juve si noterë dhe avokatëve ?

Ne nuk kemi kurëfarë lidhje me avokatët. Ato vetëm vijnë në seancë, vetë ose me palët, e nënshkruajnë procesverbalin dhe kaq, përfundon roli i tij(avokatit). Ai vetëm rri këtu në qoftë se noteri i drejton pyetje palës rreth masës trashëgimore, rreth pjesëmarrjes, do të bëhet trashëgimtarë apo heqë dorë, apo do ta kontestojë vendimin. Të gjitha këto i bën pala , në mungesë të palës avokati e luan këtë rol.

3. Si e shqyrtoni transmisionin dhe përfaqësimin? Si veproni në këto raste?

Nuk ndryshohet asgjë. Nëse zhvillohet procedurë trashëgimore për prindërinë e një personi që ka vdekur në ndërkohë(trashëgimtarë), noteri hap procedurë. Procedura hapet me propozim të palës ose exofficio, por tek ne 90% hapet me kërkesë të palës dhe noteri kërkon dëshmi për lidhje farefisnore. Dhe në atë rast pala pjesëmarrëse që pretendon që është trashëgimtarë dëshmon se femiu i trashëgimtarit ndërkohë ka vdekur dhe me certifikatë të vdekjes e dëshmon dhe nëse pretenduesi për trashëgimi është djali i atij që

ka vdekur në ndërkohë ai me automatizëm shëndrohet si trashëgimtarë të brezit bazë. Ai lloj i trashëgimisë do të thotë me automatizëm shëndrohet në trashëgimtarë të brezit të parë, sepse fakti që ka vdekur femiu i trashëgimlënësit me automatizëm e zhvendos rendin trashëgimor të këtij dhe ai bëhet trashëgimtarë të brezit të parë në vend të prindit të tij.

4. Sa raste ka pasur që femra ka dhënë deklaratë për heqje dorë nga trashëgimia dhe se refuzimin e kanë dhënë personalisht ato apo nëpërmjet avokatit ?

Po ka raste të heqjes dorë, jo vetëm të trashëgimtarëve të gjinisë femërore, por edhe të gjinisë mashkullore. Megjithatë tek shqiptarët ka raste të shpeshta kur trashëgimtarët ligjor(femër) heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë. Nëse ka pëfaqësues ligjor paraprakisht tek advokati jep deklaratë së bashku me autorizimin.

5. Si do kishit vepruar nëse do të kishit hasur me reproduksion post human(post mortum)?

Nuk kemi pasur këso raste deri më tani. Megjithatë, në këtë rast ai fëmi është i barabartë me trashëgimtarët e tjerë.

5.3 Intervista me noteren Nita Xhaferi Iseni (e realizuar më 18.12.2020)

1. Në procedurë trashëgimore a i thërisni të gjithë palët, apo si veproni ?

Për hapjen e procedurës së trashëgimisë fillimisht duhet të ekzistojnë katër kushte themelore edhe atë: vdekja faktike e personit fizik, ekzistimi i masës trashëgimore, ekzistimi i trashëgimtarëve dhe ekzistimi i bazës juridike për thirrje në trashëgimi. Me vdekjen e personit fizik hapet masa trashëguese dhe thirren trashëgimtarët e trashëgimlënësit për ti trashëguar të drejtat dhe detyrimet të cilat e përbëjnë masën trashëgimore të trashëgimlënësit apo decujusit. Për sa i përket thirrjes apo përcaktimit të trashëgimtarëve gjithmonë bazohemi në nenet e Ligjit për Trashëgimi edhe atë duke i respektuar rradhët e trashëgimisë, në rastet kur mungojnë trashëgimtarët e rendit të parë vazhdohet me rendin e dytë të trashëgimtarëve e në mungesë të rendit të dytë të trashëgimtarëve vazhdohet me rendin e tretë e kështu me rradhë. Gjatë udhëheqjes së procedurës së trashëgimisë në mënyre të saktë dhe koncize përcaktohen trashëgimtarët apo pasardhësit e trashëgimlënësit të cilët kanë drejtë apo bazë juridike për thirrje në trashëgimi identiteti i të cilëve konstatohet me dokumente identifikimi dhe çertifikatat e lindjes të lëshuara nga organet kompetente. Gjatë realizimit të procedurës së trashëgimisë duhet të sigurohemi që trashëgimlënësi nuk ka lënë pas tij trashëgimtarë të tjerë të cilët kanë të drejtë në trashëgimi të cilët nuk përfshihen në procedurën trashëgimore. Në shumicën e rasteve gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore trashëgimtarët nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në procedurë, por përfaqësohen nga përfaqësuesit ligjorë.

2. Na tregoni për bashkëpunimin mes juve si noterë dhe avokatëve?

Për mbarëvajtjen e procedurave ligjore të cilët zhvillohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut bashkëpunimi mes noterëve dhe avokatëve është i pashmangshëm, pasi që vet proceset që zhvillohen janë të tilla që parashohin një bashkëpunim reciprok dhe të vazhdueshëm mes këtyre dy subjekteve. Gjatë zhvillimit të proceseve normalisht kemi kolegë me të cilët kemi krijuar një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të mirëfilltë por në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë nuk i imponojmë klientët tanë që të zhgjedhin apo tu'a besojnë lëndën e tyre tek avokatët me të cilët ne kemi bashkëpunim si noteriat, klientët gjithnjë kanë lirinë e zgjedhjes dhe të përcaktimit të avokatit me të cilin dëshirojnë të bashkëpunojnë. Ne

si noteriat mund vetëm që të japim sugjerime për klientët tanë, e drejta e zgjedhjes u takon ekskluzivisht tyre.

3. Si e shqyrtoni transmisionin dhe përfaqësimin? Si veproni në këto raste?

Në trashëgimin ligjore ekzistojnë dy institute juridike përfaqësimi dhe transmisioni të cilët dallojnë, janë dy institute juridike që fillimisht duken të njëjta por në fakt dallojnë shumë nga njëra tjetra. Me përfaqësim në trashëgimi nënkuptojmë situatën në të cilën pasardhësi i trashëgimtarit të të ndjerit (trashëgimlënësit të parë) thirret në trashëgimi, dhe fiton të drejtën për të trashëguar kur trashëgimtari ka ndërruar jetë para trashëgimlënësit. Më konkretish ka të bëjë me situatën kur ka vdekur babai, nëna e fëmijëve para gjyshit, gjyshes të tyre. Në këtë rast pasi të vdes gjyshi/gjyshja fëmijët kanë të drejtë të trashëgojnë pjesën që do t'i takonte babait, nënës të tyre, nëse do ishte gjallë pasi të ndërronte jetë gjyshi/gjyshja.

Me trashëgimi të transmittuar nënkuptojmë situatën, trashëgimtari vdes pas trashëgimlënësit por pa mos u deklaruar për trashëgimin apo pa mos filluar procedura e trashëgimisë, pra në rastet kur ka vdekur gjyshi/gjyshja, por pa u hapur procedura trashëgimore vdes edhe babai/nëna e fëmijëve, duke mos u deklaruar nëse e pranon ose jo trashëgiminë. Në këtë rast për dallim nga rasti i parë në trashëgimi mund të thirret edhe bashkëshorti/ja e të ndjerit të dytë, për të trashëguar të shoqin/en.

Në këto raste ne si zyrë noteriat jemi mjaftë të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm me qëllim që të mos krijojmë një laramani në procedure gjyqësore, në rastet kur duhet të zbatohet trashëgimia transmissive mostë zbatohet përfaqësimi me qëllim që të mos diskriminohet bashkëshorti/ja duke e mënjanuar nga e drejta për të trashëguar.

4. Sa raste ka pasur që femra ka dhënë deklaratë për heqje dorë nga trashëgimia dhe se refuzimin e kanë dhënë personalisht ato apo nëpërmjet avokatit ?

Sipas Ligjit për trashëgimi të RMV-së kemi barazi të plotë mes personave me gjini të kundërt gjatë procedurave trashëgimore, të dy gjinit si personat që i përkasin gjinisë mashkullore dhe femrore janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë që të trashëgojnë në mënyrë të njëjtë dhe në pjesë të barabarta nga masa trashëgimore e trashëgimlënësit. Edhe pse gjatë zhvillimit të procedurave trashëgimore kjo e drejtë i'u potencohet palëve por përsëri lirishtë mund të them

diku 80 % e trashëgimtarëve me gjini femërore heqin dorë nga pjesa e cila u takon me ligj. Heqja dorë nga trashëgimia si fenomen ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistoj edhe sot ku më së shumti vërehet tek femrat shqiptare, përse i përket mënyrës së dhënies së deklaratës për heqje dorë na trashëgimia në shumicën e rasteve këto deklarata jepen nëpërmjet përfaqësuesit ligjorë respektivisht avokatit.

5. Si do kishit vepruar nëse do të kishit hasur me reproduksion post human(post mortum)?

Reproduksioni post human apo thënë ndryshe post mortum është një fenomen apo dukuri mjaftë e re por edhe aq sensitive për ne dhe për gjithë shoqërinë tonë, nga arrtijet e fundit biomedicinale mundësohet lindja e fëmijës pas vdekjes së babait duke e përdorur materialin gjenetik të cilin e ka deponuar babai duke qenë gjallë. Republika e Maqedonisë së Veriut është një ndër shtetet që e njeh dhe e lejon përdorimin e kësaj metode por për fat të keq edhe pse e ka lejuar reproduksionin artificial në të njëjtën kohë nuk e ka realizuar harmonizimin e ligjit për trashëgimi pra ekziston një ndeshje apo mospërputhje ligjore. Personalisht ne si notariat ende nuk kemi pasur një rast të tillë ku trashëgimtari të ketë lënë një deklaratë me anë të së cilës ka lejuar që të përdoret materiali i tij gjenetik pas vdekjes së tij, por në qoft do të duheshte të jem e sinqert ky rast do të ishte një ndër rastet më të vështira në procedurë trashëgimore pasi që në njëërën anë janë trashëgimtarët të cilët kanë të drejtë për trashëgimi e në njëërën anë një deklaratë e trashëgimlënësit sipas të cilës në një të ardhme mund të vijë në jetë edhe një trashëgimtarë i tij. Ndarja e menjëhershme e masës trashëguese të trashëgimlënësit mund të çoj deri tek rrezikimi i së drejtës trashëgimisë së personit i cili mund të lind në të ardhmen nga materiali gjenetik i trashëgimlënësit e në anën tjetër mosndarja e trashëgimisë paraqet cënim të të drejtave të trashëgimtarëve aktual.

Në këtë rast më e drejtë do të ishte që bashkëshortja e trashëgimlënësit të trashëgoj dy pjesë apo hise nga trashëgimia e bashkëshortit të ndjerë edhe atë një pjesë për vete sipas ligjit që i takon e një pjesë për fëmijën të cilën mund ta lind nga materiali gjenetik i bashkëshortit të ndjerë të cilin e ka deponuar duke qenë gjallë me ç'rast i garantohet e drejta e trashëgimisë personit i cili mund të lind në të ardhmen nga materiali gjenetik i babait të ndjerë.

5.4 Analiza dhe krahasimi i të dhënave të përfituara nga intervistat

Nga rezultatet e studimit dhe të intervistave të realizuara me noterët, mund të përmenden disa informata mjaft interesante. Në këtë pjesë do bëhet analizimi i përbashkët i intervistave si dhe krahasimi i tyre. Me këto intervista do të mund të shihet qartë mendimi dhe qëndrimi i të intervistuarve rreth çështjes së rolit të tyre (noterëve) në të drejtën trashëgimore.

5.4.1 Krahasimi i të dhënave nga intervistat

Sa i përket seancës trashëgimore tek noterët, sipas deklaratës së tyre mund të kuptojmë që palët mund të mos marrin pjesë në atë procedurë (seancë), sepse ata detyrimisht duhet të kenë përfaqësues të tyre dhe procedura mund të zhvillohet pa palët, por patjetër në prezencë të përfaqësuesve të tyre (avokatëve) dhe poashtu me deklaratat e palëve nga ana e avokatëve të tyre. Në këtë aspekt vjen në shprehje me bashkpunimi i noterëve dhe avokatëve, dhe sipas noterëve e vetmja ndërlidhje mes tyre dhe avokatëve është se ata paraqiten si autorizues të trashëgimtarëve dhe pa to nuk mund të zhvillohet seanca për trashëgimi. Sigurisht që ata kanë kolegë me të cilët krijojnë bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të mirëfilltë por në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë nuk i imponojnë klientët e tyre që të zhgjedhin apo të u'a besojnë lëndën e tyre tek avokat të caktuar.

Fakti interesant qëndron në atë se shumica e noterëve nuk janë në dijeni apo thënë ndryshe nuk janë të njohur me termin “transmission” dhe po të njëjtën e ngatërrojnë me përfaqësimin. Me transmission në trashëgimi nënkuptojmë situatën kur trashëgimtari vdes pas trashëgimlënësit por pa mos u deklaruar për trashëgimin apo pa mos filluar procedura e trashëgimisë, pra në rastet kur ka vdekur gjyshi/gjyshja, por pa u hapur procedura trashëgimore vdes edhe babai/nëna e fëmijëve, duke mos u deklaruar nëse e pranon ose jo trashëgiminë. Kurse me përfaqësim nënkuptojmë se pasardhësi i trashëgimtarit të të ndjerit (trashëgimlënësit të parë) thirret në trashëgimi, dhe fiton të drejtën për të trashëguar kur trashëgimtari ka ndërruar jetë para trashëgimlënësit. Me përfaqësim bashkëshortja nuk e trashëgon bashkëshortin e ndjerë para vjehrrit të saj, por në këtë rast trashëgimtarë paraqiten vetëm fëmijët e saj, sepse bashkëshortja e

ka trashëguar bashkëshortin kur ka ndëruar jetë ai, kurse tek trashëgimia e transmetuar bashkeshorti/bashkeshortja paraqiten si trashëgimtarë, sepse bashkëshorti apo bashkeshortja ka jetuar më gjatë se prindi tij/saj dhe pas vdekjes së bashkëshortit/bashkëshortes e drejta e tij pë të deklaruar nëse e pranon apo jo trashëgiminë do i takonte ati/asaj sepse kjo e drejtë kalon tek trashëgimtarët e tij, që në këtë rast bën pjesë edhe bashkeshorti/bashkeshortja.

Sa i përket deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia nga ana e gjinisë femërore si nga rastet ne si qytetarë që shohim dhe dëgjojmë ashtu edhe nga praktika e e noterëve, ku edhe ata vetë deklarojnë se shumica e femrave e sidomos të popullsisë shqiptare, pra, mund të themi afro 80% e tyre japin deklaratë negative, që heqin dorë nga trashëgimia, ajo trashëgimi e cila atyre i'u takon me ligj dhe se ky fakt qysh në të kaluarën ende vazhdon të egzistojë edhe në ditët e sotme. Patjetër që ka përjashtime po megjithatë po flasim në mënyrë të përgjithësuar.

Reproduksioni post human apo ndryshe thënë post mortum nga shumica e noterëve, me disa përjashtime, nuk ishte e njohur për ta dhe pas shpjegimit të bërë për këtë dukuri ata treguan që nuk kishin pasur këso raste po megjithatë edhe në atë rast ai fëmi është i barabartë me trashëgimtarët e tjerë, dhe se nëna si e autorizuar, përfaqesues ligjor i fëmijës shpallet si kujdestar, përkatësisht fëmija shpallet trashëgimtarë, por përmes së ëmës si kujdestar ligjor. Megjithatë kjo dukuri përzihej me rastet kur fëmija lind pas vdekjes së trashëgimlënësit, ku ndërkohe te reproduksioni post human fëmija jo vetëm që lind pas vdekjes së trashëgimlënësit, por edhe fillon fekondimi duke e përdorur materialin gjenetik të cilin e ka deponuar babai duke qenë gjallë.

5.5 Anketa

Pjesë shumë të rëndësishme dhe nga e cila janë nxjerrur shumë përfundime është gjithsesi edhe anketimi i pjesëtarëve të shoqërisë dhe ekspertëve në këtë lëmi rreth çështjeve trashëgimore. Janë anketuar 150 persona të profesioneve të ndryshme, e të cilat rezultate i paraqiten në pjesën e mëposhtme.


Në anketë janë përdorur pyetjet në vijim në gjuhën shqipe dhe maqedonase :

1. Gjinia/ Пол:
2. Mosha juaj/ Вашата возраст:
3. Përkatësia etnike/ Етничка припадност:
4. Profesionit juaj/ Вашата професија?
5. A i besoni noterit në punën e tij në çështjen e procedurës trashëgimore?
Дали му верувате на нотарот во неговата работа во постапката за наследство ?
6. Nëse po, sa/ Ако да, колку:
7. A keni qenë pjesmarrës në ndonjë procedurë për shqytrimin e trashëgimisë?
Дали сте учestvувале во некоја постапка зарасправање на оставина?
8. Si mendoni, a i realizojnë noterët në mënyrë të drejtë dhe të paanshme procedurat e trashëgimisë? / Дали мислите , дека нотарот ја спроведува постапката за расправање на оставината фер и непристрасно?
9. A jeni pro barazimit të bashkësisë martesore dhe jashtëmartesor në trashëgiminë ligjore?
Дали сте за изедначување на брачната и вонбрачната заедница во законското наследство ?
10. A jeni pro barazisë gjinore në trashëgimi?
Дали сте за родова еднаквост во наследувањето ?
11. A konsideroni që me anë të testamentit sigurohet vullneti i fundit i trashëgimlënësit?
Дали сметате дека со тестаментот се обезбедува последната волја на оставителот?

Rezultatet nga pyetja e parë paraqiten në grafikonin si vijon:

1. Gjinia/ Пол ?


147 responses



Gjate përgjigjeve të marra nga ky pyetësor jemi munduar të kemi një diverzitet të përgjigjeve, ku rezulton se gjinia femërore është përgjigjur 61%, kurse gjinia mashkullore 39%.


2. Moshja juaj/ Вашата возраст ?

147 responses




Gjatë pyetjes se çfarë moshe janë përgjegjur në këtë pyetësor shihet se 67% e të anketuarve janë të moshës së mesme duke mbledhur moshat 26-49 dhe ku vërtetësia e këtij pyetësori ka një normë të lartë të saktësisë.

3. Përkatësia etnike/ Этничка припадност?



Sa i përket etnicitetit rreth kësaj ankete mund të themi se shumica e të anketuarve janë të kombësisë shqiptare, ku prej 150 anketues 131 janë shqiptar, 12 maqedonas, 4 turk, 3 boshnjak .

4. Profesionit juaj/ Вашата професија?




Çështja e profesionit të të anketuarve flet shumë rreth kuptimit mbi të drejtat trashëgimore. Nga grafikoni mund të shifet qartë se arsimimi i të anketuarve është i llojlojshëm dhe kjo luan rolin kyq për të patur një mostër më të saktë nga të gjitha shtresat e shoqërisë.

Në figurën lartë shihet se të anketuarit janë të profesioneve të ndryshëm ku profesioni jurist dhe ekonomist mbizotron edhe pse ne kemi dashur që pyetjet e kësaj ankete të mos lidhen drejtëpërsëdrejti me arsimimin e të anketuarve, ku kjo mënyrë ka ndikuar që edhe të anketuarit pa ndonjë profesion të caktuar të jenë të lirë të shprehin mendimin e tyre.

5. A i besoni noterit në punën e tij në çështjen e procedurës trashëgimore? Дали му верувате на нотарот во неговата работа во постапката за наследство ?

149 responses




Rreth besimit të punës së noterëve të anketuarit janë përgjigjur me 98% se kanë një besim rreth çështjeve që noteri i realizon me anë të ligjit dhe nuk kanë asnjë dyshim për këtë.

Besueshmëria ndaj noterit thuajse është maksimale dhe shihet qartë edhe në figurën 5 dhe 6 ku përgjigjet pozitive të marra rreth kësaj çështje kanë një përqindje maksimale.

6. Nëse po, sa/ Ако да, колку:


148 responses



Edhe pse të anketuarit rreth besimit të punës së noterit shihet se 50.7% janë përgjigjur mesatarisht dhe 44.7% janë përgjigjur që shumë kanë besim në rolin e vendimmarrjes së noterit dhe një pjesë e vogël e të anketuarve nuk janë përgjigjur rreth kësaj pyetje, mund të themi se thuhet se 95% e të anketuarve rreth kësaj pyetje kanë besim tek noterët dhe roli i tij ka një vendimmarrje të pranuar për ta. Ligji i cakton të drejtat dhe detyrat edhe pse ndonjëherë nuk ka pëlqyeshmëri për të gjithë.

7. A keni qenë pjesëmarrës në ndonjë procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë? Дали сте учествувале во некоја постапка за расправање на оставина?

149 responses



Gjatë pyetjes se a kanë marrë pjesë në procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë të anketuarit janë përgjigjur si në figurën e 7 dhe shihet se 65% e të anketuarve nuk kanë qenë pjesëmarrës në

procedura të trashëgimisë dhe 35% kanë qenë pjesëmarrës në ndonjë shqyrtim të trashëgimisë dhe shihet se një pjesë e të anketuarve gjatë pjesëmarrjes në procedurë trashëgimore kanë mësuar që ligji cakton të drejtat e tyre dhe besueshmëria ndaj rolit të noterit të jetë e padiskutueshme.

8. Si mendoni, a i realizojnë noterët në mënyrë të drejtë dhe të paanshme procedurat e trashëgimisë? / Дали мислите , дека нотарот ј... расправање на оставината фер и непристрасно?
149 responses





Figura e 8 na tregon se realizimi i të drejtës për paanësi të procedurave rreth trashëgimisë 96% e të anketuarve mendojnë që nuk ka keqpërdorime nga ana e noterëve. Nga kjo kuptojmë se qytetarët i besojnë noterit dhe saktësia e realizimit të procedurave sa i përket trashëgimisë janë në nivel të duhur.

9. A jeni pro barazimit të bashkësisë martesore dhe jashtëmartesor në trashëgiminë ligjore? Дали сте за изедначување на брачната и вонбрачната заедница во законското наследство ?


149 responses



Nga pyetja rreth bashkësisë jashtëmartesore dhe të drejtave trashëgimore shihet që 66% e të anketuarve janë pro barazimit për trashëgimi dhe rreth 34% nuk e pranojnë dhe janë kundër të drejtave trashëgimore në bashkësi jashtëmartesore. Mund të thuhet se parashtrimi i pyetjes rreth barazimit ndikon sidomos në të kuptuarin e drejtë të detyrimit të mëtutjeshëm dhe bartjen e pasojave nga aktet e krijuara, por fakti që përgjigjet e të anketuarve kanë qenë të ndara në këto përgjigje dhe niveli i tyre i arsimimit ka qenë i lartë na le të kuptojmë që përqindjet e përgjigjes janë reale.

10. A jeni pro barazisë gjinore në trashëgimi? Дали сте за родова еднаквост во наследувањето ?


149 responses



Në pyetjen se a janë pro barazisë gjinore në trashëgimi 87.9% e të anketuarve janë përgjigjur pro dhe vetëm 12.1% janë përgjigjur që nuk janë pro barazisë gjinore në trashëgimi. Pasi që rezultatet tregojnë këtë grafik mund të thuhet se një pjesë e kënaqshme e mostrës së krijuar janë në gjendje të kuptojnë që rëndësia e barazisë gjinore ka një rol shumë të madh. Dihet qartë se deri në kohët e fundit kjo ka qenë një lloj diskriminimi rreth ndarjes së trashëgimisë në baza gjinore.

11. A konsideroni që me anë të testamentit sigurohet vullneti i fundit i trashëgimlënësit? Дали сметате дека со тестаментот се обезбедува последната волја на оставителот?

149 responses



Vullneti i fundit i trashëgimlënësit rreth testamentit konsiderohet shumë i lartë ku rreth 95% e të anketuarve janë përgjigjur që e konsiderojnë një siguri për trashëgimi dhe një pjesë prej 5% nuk e pranojnë këtë.

6 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Noteritë e vendeve tona mbajnë si „target“ krijimin e një noterie moderne, duke privilegjuar afirmimin e padiskutueshëm të noterisë latine, e cila është më e pëlqyeshme nga njohësit e mirë të noterisë. Tema thuhet të jetë krijuar në atë aspekt që kuptimi i saj të ndikojë në thjeshtësinë e të kuptuarit të së drejtës trashëgimore dhe të kuptojmë që roli i noterit është vetëm vërtetimi i ligjshmërisë së dokumenteve të caktuar dhe aplikimi i atyre dokumenteve për procedurë të mëtutjeshme.

Përcaktimi i të drejtës trashëgimore dhe procedurat e përdorura për arritje të vendimit janë të theksuara dhe të shtjelluara në atë menyrë që të kuptojmë se çfarë detyra dhe përgjegjësi ka noteri në momentin kur merr vendim për procesimin e procedurave nga gjykata themelore. Pas marrjes së të drejtës së procesimit të lëndës përmes procedurave të theksuara nga gjykata atëherë detyrat kryesore të noterit janë vetëm vazhdimi në mënyrë korrekte për procesim dhe mos keqpërdorimi i të drejtave të tij për marrjen e vendimit të vlefshmërisë së dokumenteve të caktuara.

Një ndër aspektet e rëndësishme është edhe marrja e vendimeve të drejta në atë mënyrë që njëanshmëria të jetë e drejtë dhe jo të merren vendime për përfitime personale ose vendime të anshme vetëm për njërin palë me që llim të dëmtimit të palës tjetër.

Gjatë përpilimit të temës një rol shumë të madh ka edhe literatura si dhe intervista me noterët e përzgjedhur për këtë hulumtim.

Rëndësia kryesore për kuptimin e rolit të noterit në të drejtën trashëgimore qëndron në faktin se e drejta trashëgimore është një ndër çështjet më të rëndësishme tek qytetarët.

E drejta trashëgimore është një pjesë e drejtës civile që rregullon marrëdhëniet pasurore që rrjedhin me rastin e vdekjes së një personi, do të thotë që rregullon transferimin e të drejtave dhe detyrimeve pasurore nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët e tij. Lënda e rregullimit të së drejtës trashëgimore është trashëgimia, që nënkupton transferimin e sendeve, të drejtave pasurore dhe detyrimeve nga trashëgimlënësi te trashëgimtarët e tij. Trashëgimia ndodh në momentin e vdekjes së një personi, kur në të njëjtën kohë shuhet subjektiviteti i tij, dhe të drejtat dhe detyrimet e tij pasurore transferohen te trashëgimtarët. Bazuar në këtë, në mënyrë që të ndodhë

një trashëgimi dhe formimi i një marrëdhënie trashëgimie, është e nevojshme që një person fizik që ka një trashëgimi të vdesë dhe të ketë trashëgimtarë që kanë një bazë ligjore të thirren për të trashëguar.

Meqë çdo vendim që merret nga noterët është i përcaktuar në ligjin për trashëgiminë atëherë nuk parashihet që të ketë ndonjë pengesë për marrjen e vendimeve për çështjen e trashëgimisë dhe parashtrimi i parregullsive parashihet të jetë minimal për vendosje të trashëgimtarit.

Sa i përket riprodhimit artificial post human, mund të shihet qartë tek intervistat se ekziston një keqkuptim apo mosnjohuri e noterëve sa i përket kësaj çështje dhe përzihet me rastin e lindjes së fëmijës pas vdekjes së prindit. Riprodhimi artificial post human është i lejuar tek ne, por fëmija i lindur me këtë mënyrë nuk gëzon të drejta të barabarta në çështjet trashëgimore si fëmijët e tjerë martesorë apo jashtëmartesor. Kjo zgjidhje ligjore duhet të ndryshohet dhe duhet të njihet e drejta e fëmijëve të ngjizur pas vdekjes(post human) për të trashëguar sipas të njëjtave rregulla si fëmijët e tjerë martesor apo jashtëmartesor. Nëse ligjvënësi lejon dhe rregullon ligjërisht fekondimin post human, atëherë ai duhet të parashikohej që fëmijët të jenë në gjendje të trashëgojnë nga babai i tyre. Nga kjo paraqitet nevoja e harmonizimit të Ligjit për trashëgiminë me Ligjin për fekondim të asistuar biomjekësorë, sepse duke mos u përputhur këto dy ligje hasemi në diskriminim ndaj fëmijëve. Ky lloj i diskriminimit është i papranueshëm, prandaj duhet të bëhen ndryshime në Ligjin për trashëgimi.

Edhe me trashëgiminë e transmetuar mund të themi njëjtë sikurse për riprodhimit artificial post mortem apo thënë ndryshe post human, sepse edhe për këtë institut ka shumë dilema dhe ngatërime me përfaqësimin, jo vetëm tek qytetarët por njëashtu shumë edhe nga ana e noterive. Në vend që të bëhet dallimi mes këtyre dy institute të ndryshme, në procedurën e ndarjes së trashëgimisë, institucionet e së drejtë zbatojnë përfaqësimin në të dyja rastet, edhe kur trashëgimtarit vdes pas trashëgimlënësit edhe kur trashëgimtarit vdes para trashëgimlënësit, me ç'rastë paraqitet diskriminimi ndaj bashkëshortes/bashkëshortit, duke e anashkaluar atë nga e drejta për të trashëguar. Me përfaqësim bashkëshortja nuk e trashëgon bashkëshortin e ndjerë para vjehrrit të saj, por në këtë rast trashëgimtarë paraqiten vetëm fëmijët e saj, kurse tek trashëgimia e transmetuar bashkeshorti/bashkeshortja paraqiten si trashëgimtarë.

Në legjislacionin trashëgimorë të RMV-së duhet të parashihet edhe krijimi i sistemit të regjistrimit të testamenteve tek noterët që do të udhëheqej nga Oda e noterëve, për të ofruar një siguri juridike se do të realizohet vullneti i fundit i testamentlënësit.

Kjo tezë e magistraturës rreth punës së zyrave të noterive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë për çështjet e trashëgimive të pronave nxjerr përfundim se noteritë luajnë një rol relevant për këtë fushë të drejtësisë në vendet e lartpërmendura. Hipoteza e vendosur në këtë hulumtim se efekti i noterisë në përshpejtimin e procedurës për trashëgiminë e pronës në komparacion me funksionin e gjykatave është vërtetuar duke u mbështetur në rezultatet e gjetjeve të këtij punimi.

7 LITERATURA E SHFRYTËZUAR

LIBRAT:

- Lirim Begzati, “Noteria jonë”, 2010
- Petraq Çuri , “E drejta procedural civile & Noteria” , 2008
- Angel Ristov & Dejan Mickovikj “Nasledno Pravo” , 2020
- Zhan Karbonie ,, Gragjansko pravo“ Volum II, 2004
- Hamdi Podvorica, “E drejta trashëgimore“ , Prishtinë 2006
- Dr.Borislav T. Blagojevic, Nasledno pravo, “Naucna knjiga”, Beograd
- Laura Vorpsi “Trashëgimia në të drejtën ndërkombëtare private”, Tiranë 2015
- Shqipe Shaqiri “Roli i noterive në trashëgiminë e pronave”, 2016
- Cristinel Ioan Murzea “The notary testamentary procedure- a form of justice which goes beyond the court of law” ,2015
- Pierre Rochat, “Quelques reflexions sur la profession de notaire” in JDT 1966 III 2001
- Annee Revue notariale bellge, Bruxelles, 13 Octomber 2014
- J. H. Lipsius, “Das attische Recht u. Rechtsverfahren“, Lipsia 1905-15
- Prof.Dr Dejan Mickovikj „Reproduksioni post-human dhe e drejta trashëgimore“ 2010

ARTIKUJ:

- J. M. Powis Smith, “The origin and history of Hebrew law”, Chicago 193
- Dentologjia dhe rregullat e organizimit të noterive, Dokument i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të noterive anëtarëve në Lima, me 8 tetor 2013
- Stoeb Fidanco, “Pozicioni dhe kompetencat e noterit si i besuar i gjykatës në procedurë trashëgimore”, notarius nr.11
- Dragan Tumanovski, Notarius, nr.1
- Arsen Jamevski, Notarius nr.1 ,
- Mishel Korbie, Notarius nr.1, 2000
- Nikolla Kajcevski , Notarius, nr2, 2002
- Nada Palikj , Notarius, nr.3, 2003
- Zlatko Nikolovski , Notarius nr.10, 2008
- Arsen Janevski , Notarius nr.12, 2008
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2019 – 2023, Prishtinë
- Marrëveshje e projektit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës për projektin Themelimi i Sistemit të Noterisë, Faza III (2012)
- Ekstrakt nga një pjesë e fjalimit me të cilin ish-kryetari I Republikës së Polonisë, Lech Kachinsky, iu drejtua pjesëmarrësve të kongresit të II-të të noterëve të Unionit Evropian, I cili u mbajtë në Varshavë, prej 10 deri 12 shtator 2008.
- Arta Selmani-Bakui “Sistemet juridike- trashëgimore bashkëkohore”, 2019

AKTET JURIDIKE:

- Ligji për Noteri në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.72, 2016)
- Ligji për Noterinë në Republikën e Shqipërisë (Gazet Zyrtare Nr. 110, 2018)
- Ligji për Noterinë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.23, 2018)
- Ligji mbi trashëgiminë i RMV (Gazeta Zyrtare Nr.8084, 1996)
- Ligji për procedurë jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare nr.09, 2008)
- Oda e Noterëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Ligji i marrëdhënieve detyrimore i RM (Gazeta Zyrtare nr.18/2001)
- Ligji për trashëgiminë në Kosovë (Gazeta Zyrtare nr. 3, 2006)
- Ligji nr.06/008 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë.
- Ligji nr. 03/L-007 për procedurë jokontestimore të Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.45, 2009)
- Ligji nr. 06/l-007 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-007 për procedurën jokontestimore (Gazeta Zyrtare nr. 22/18)
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr 7850, 29.07.1994
- Ligji nr.8781 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7850, 03.05.2001

BURIME NGA INTERNETI

- <https://www.eda.admin.ch/sdc>
- <https://www.nkrm.org.mk/index.php/pages-2/notarius>
- <https://www.nkrm.org.mk>
- <https://juristat.files.wordpress.com/2012/02/e-drejta-trashegimore.pdf>
- <https://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=1&CatID=119,0>
- https://www.eda.admin.ch/dam/countries/countries-content/kosovo/en/Project-list-September-2015_EN.pdf
- <https://www.pravdiko.mk/>
- <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,42>